

Nr. 1693..... Prot.
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27/03/2023

Drejtuar: KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË KESH SH.A.

Për dijeni: MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Lënda: Informacion mbi aktivitetin e shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2022.

Me qëllim informimin periodik, në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" (i ndryshuar), VKM Nr. 620, datë 22.10.2021 (i ndryshuar me VKM Nr. 456, datë 29.06.2022), liçencave për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit, tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, Ligjit Nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), si dhe akteve të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë, KESH sh.a. ka përgatitur raportin e aktivitetit të saj (prodhim, tregtim, furnizim të energjisë elektrike, investime dhe ecurinë ekonomiko-financiare) për vitin 2022, të cilin e gjeni bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj, me respekt,

ADMINISTRATORI
Ergys VERDHO



RAPORT
“AKTIVITETI I SHOQËRISË KESH SH.A. PËR VITIN 2022”

Mars 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

AKRONIME	3
1. SITUATA NË TË CILËN SHOQËRIA USHTROI VEPRIMTARINË E SAJ PËR 2022	4
2. ZHVILLIMET KRYESORE TË AKTIVITETIT DHE NGJARJE TË 2022	4
2.1 SITUATA E TREGJEVE TË ENERGJISË DHE PLANI I EMERGJENCËS.....	4
2.2 MASAT E MARRA PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS SË EMERGJENCËS	6
2.3 PROGRAMI EKONOMIKO-FINANCIAR I KESH SH.A. PËR VITIN 2022.....	7
2.4 PËRMBLEDHJE E SITUATËS HIDRIKE.....	9
2.5 TË DHËNAT KRYESORE OPERATIVE TË AKTIVITETIT TREGTAR DHE EKONOMIK.....	11
2.6 KOMERCIALIZIMI I MËTEJSHËM I AKTIVITETIT	12
3. ÇËSHTJE LIGJORE/RREGULLATORE TË LIDHURA ME VEPRIMTARINË.....	13
4. AKTIVITETI PRODHUES, MIRËMBAJTËS DHE EFIÇENCA NË SHFRYTËZIM	18
4.1 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE – OPERIMI.....	18
4.2 SIGURIA E VEPRAVE HIDROTEKNIKE	22
4.3 MIRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I AGREGATEVE	22
4.4 CILËSIA E PRODHIMIT	24
5. BILANCI ENERGJETIK DHE AKTIVITETI TREGTAR PËR VITIN 2022	25
5.1 ANALIZA E BILANCIT ENERGJETIK	25
5.2 AKTIVITETI NË PLOTËSIMIN E DSHP	27
5.3 AKTIVITETE TREGTARE TË TJERA	30
6. AKTIVITETI INVESTUES 2022	33
6.1 REALIZIMI I INVESTIMEVE PËR VITIN 2022	33
6.2 INVESTIMET E FINANCUARA NGA PARTNERËT NDËRKOMBËTAR	35
6.3 INVESTIMET ME FONDET E VETA.....	37
6.4 ECURIA E PROJEKTEVE BRE DHE PËRGJEGJSHMËRIA SOCIAL-MJEDISORE	38
7. AKTIVITETI EKONOMIKO-OPERACIONAL PËR VITIN 2022	40
8. KONKLUZIONE	43

AKRONIME

APA	- Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të KESH sh.a.
ALPEX	- Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
BB	- Banka Botërore
BERZH	- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BRE	- Burimet e Rinovueshme të Energjisë
DSHP	- Detyrimi për Shërbim Publik
EIP	- Plani i Investimeve Ekonomike të Bashkimit European në Ballkanin Perëndimor
ERE	- Enti Rregullator i Energjisë
FMF	- Furnizuesi i Mundësisë së Fundit
FTL	- Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.
FSHU	- Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.
HUPX	- Bursa Hungareze e Energjisë
HUDEX	- Bursa Hungareze e Derivateve të Energjisë
KESH	- Korporata Elektroenergetike Shqiptare sh.a., ose në vijim Korporata/Shoqëria
KfW	- Banka Gjermane e Zhvillimit
KOSTT	- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
MFE	- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
OST	- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike sh.a.
OSHEE Grup	- Grupi Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
OSSH	- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
PEF	- Programi Ekonomiko-Financiar i KESH sh.a.
PVPE	- Prodhuesit e Vegjël me Përparësi të Energjisë
REMIT	- Rregullore për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë
SECO	- Sekretariati Shtetëror i Çështjeve Ekonomike i Zvicrës
WBIF	- Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor

1. SITUATA NË TË CILËN SHOQËRIA USHTROI VEPRIMTARINË E SAJ PËR 2022

Viti 2022 u karakterizua si një vit i veçantë dhe sfidues, për sektorin elektroatenergjetik në përgjithësi dhe për KESH sh.a. në veçanti. Korporata e zhvilloi veprimtarinë e saj në kushtet e emergjencës së furnizimit me energji elektrike si rezultat i krizës globale të rritjes së çmimeve të energjisë. Kjo situatë u shkaktua fillimisht nga një rritje e kërkesës për rikuperim aktiviteti, nga ekonomitë botërore gjatë periudhës post-Covid 19, sidomos në tregjet ndërkombëtare të “Commodities”, veçanërisht metaleve dhe lëndëve të tjera të para. Situata pësoi agravim si pasojë e tensioneve Rusi-Ukrainë me efekte të rritjes së çmimeve që në fillim të Shtatorit 2021, në tregjet e lëndëve djegëse duke u përcjellë në tregjet e energjisë elektrike. Me konkretizimin e konfliktit ushtarak Rusi-Ukrainë (nisur në Shkurt të 2022), kriza globale e rritjes galoponte të çmimeve të energjisë u kthye në realitet jo afatshkurtër. Efektet negative të rritjes së shpejtë të çmimeve, sidomos në tregjet evropiane, u multiplikon edhe për shkak se në konflikt u përfshinë vende si Rusia dhe Ukraina, me peshë botërore në furnizimin me lëndë të para të energjisë si gaz, naftë, qymyr por edhe minerale/metale, drithëra etj., duke përvijuar një panoramë komplekse në tregjet botërore. Veçanërisht kriza e gazit e imponuar nga ky konflikt solli në vëmendje jo vetëm faktin e varësisë së Shqipërisë në kushtet e një strukture gjenerimi vendase pothuajse 100% hidro, por edhe pasigurinë e shfaqur në importin e energjisë elektrike për shkak të burimeve të munguara (pas rritjes së çmimit të gazit si shkak i mungesës së tij dhe masave për krijimin e rezervave të gazit për periudhën e ardhshme), masave lokaliste të vendeve evropiane për mbajtjen e energjisë për konsum vendas dhe në krahun tjetër të shfaqjes së fenomenit të panikut të tregjeve, çka sjell edhe elementë të qasjes spekulative nga tregtarët.

Përballë kësaj situatë, Qeveria Shqiptare reagoi në mënyrë të menjëhershme dhe energjike duke shpallur gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, me objektiv themelor sigurimin e energjisë për konsumatorin final nëpërmjet plotësimit me çdo kusht të detyrimit për shërbimin publik në tregun e rregulluar të energjisë dhe njëkohësisht duke marrë përsipër edhe barrën financiare, për mbrojtur konsumatorin familjar dhe biznesin, duke mbajtur të njëjtin çmim të rregulluar të pandryshuar.

Shpallja e gjendjes së emergjencës u shoqërua me ndryshime ligjore dhe rregullatore përkatëse, në përshtatje me situatën, që i jep Korporatës rol qendror dhe me përgjegjësi në sigurimin e energjisë elektrike në përmbushje të DSHP-së shoqëruar me instrumentat përkatës.

Përveç faktorit të jashtëm negativ të çmimeve të rritura ndërkombëtarisht të energjisë, viti 2022 prezantoi vështirësi të shtuara edhe nga faktorë të brendshëm, pasi ky vit u paraqit në tërësinë e vet si periudhë jo e favorshme hidrike duke e bërë edhe më sfiduese situatën për Korporatën, në arritjen e objektivit të sigurimit të volumeve të energjisë në funksion të përmbushjes së DSHP-së.

Gjithsesi, përballë kësaj situatë jo të favorshme, Korporata e mbështetur edhe nga Qeveria, arriti të reagojë më së miri duke përshtatur aktivitetin përballë kushteve të reja dhe të përmbushë objektivin primar për sigurimin e energjisë dhe përballimin me sukses të situatës së emergjencës.

Gjerësisht dhe në mënyrë më të detajuar mbi këto çështje do të flitet në vijim të këtij dokumenti.


2. ZHVILLIMET KRYESORE TË AKTIVITETIT DHE NGJARJE TË 2022

Referuar panoramës së përgjithshme të përshkruar në paragrafin e mëparshëm, ndër zhvillimet kryesore, të cilat ndikuan në performancën e aktivitetit operacional-ekonomik të Korporatës gjatë 2022, mund të renditim në vijim:

2.1 SITUATA E TREGJEVE TË ENERGJISË DHE PLANI I EMERGJENCËS

Rritja e kërkesës për energji shkaktuar si kombinim i rritjes së aktivitetit global ekonomik post-pandemik dhe situatës gjeopolitike në Evropë, shkaktuan një rritje të çmimeve të lëndëve djegëse dhe veçanërisht të gazit natyror, naftës dhe qymyrit. Kjo rritje ndikoi në rritjen e çmimit të energjisë elektrike në bursat ndërkombëtare dhe sidomos në tregun evropian. Më poshtë paraqitet grafikisht kurba e çmimit mesatar mujor të energjisë, sipas Bursës Hungareze (HUPX) në mbyllje pozicioni (ATC-At The Close Order).

Grafiku 1. Çmimi mesatar mujor 2022-HUPX



Shenjat e para të rritjes së çmimeve u verifikuan që në Qershor 2021, duke vazhduar me rritje konstante dhe të shpejtë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, për të arritur në Dhjetor në nivelin mesatar 245.81 Eur/MWh. Ndërsa gjatë vitit 2022, trendi i çmimeve mesatare mujore arriti në nivele konstante të larta, duke arritur në mesatare mujore prej 270.43 Eur/MWh ose 2.4 herë më e lartë, krahasuar me mesataren e 2021 prej 113.59 Eur/MWh.

Ashtu si paraqitet edhe në grafik, muaji Gusht ka rregjistruar çmimin më të shtrenjë mesatar prej 495.29 EUR/MWh, pasi edhe kërkesa për energji është mjaft e lartë në periudhën e thatë. Pikërisht në këtë muaj rregjistrohet edhe çmimi maksimal ditor prej 748.97 EUR/MWh (30 Gusht 2022). Rritja e çmimeve në këtë periudhë, rezultoi me amplitude maksimale orare deri në 1,047 Eur/MWh.

Në përgjigje të kësaj situate dhe ndërmarrjes së masave përkatëse, Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr.584, datë 08.10.2021, shpalli gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike e cila i shtrir efektet deri në dt. 15 Prill 2022, duke vendosur ngritjen e grupit ndërinstitucional për menaxhimin e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, pezullimin e planeve të investimeve përveç atyre më të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë për shoqëritë “KESH sh.a.”, “OST sh.a.” dhe “OSHEE Group sh.a.”.

Nga ana tjetër, sipas këtij vendimi, këto shoqëri do të koordinojnë ushtrimin e aktivitetit, në përputhje me udhëzimet e MIE, me qëllim garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike.

Në vijim dhe zbatim të Vendimit nr.584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr.620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe përbalimin e parandalimit e saj”, me ndryshimin përkatës Vendimin nr.757, datë 09.12.2021, të Këshillit të Ministrave.

Sipas këtij vendimi, FSHU-së, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga KESH sh.a. KESH sh.a furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

Për qëllime të furnizimit me të gjitha sasinë e nevojshme për nevojat e FSHU-së, KESH sh.a ka të drejtë të marrë me qira asete gjeneruese termike të energjisë, të shkëmbejë/të depozitojë apo të kryejë transaksione shitblerjeje energjie në tregun e lirë.

Sipas kësaj VKM-je, KESH sh.a do të kryejë veprime shitjeje energjie dhe depozitimi/shkëmbimi vetëm pasi plotëson të gjitha nevojat e furnizimit të FSHU si edhe OSSH, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e saj.

Po sipas këtij vendimi, sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga KESH sha, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, i shitet FTL për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit të shitjes së prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike nga burime hidrike, me kapacitet të instaluar deri në 15 MW, në periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet.

Referuar VKM nr. 456; dt. 29.06.2022, në kuadër të gjendjes së emergjencës, KESH sh.a. depoziton volume energjie për mbulimin e humbjeve nga PVPE (privatë apo konçensionar) për llogari të FTL. Në rast të mosplotësimit të volumit të energjisë, diferencën e plotëson KESH.

KESH sh.a. për menaxhimin e kaskadës dhe sigurimit të energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve të rregulluar kryen procedurat sipas këtij vendimi, për depozitimin e shkëmbimin e tepërcave të energjisë elektrike, vetëm pasi ka plotësuar nevojat e FSHU. KESH sh.a. ka të drejtë të bëjë optimizim financiar të kaskadës, vetëm në rastet kur nuk cenon sasinë e nevojshme të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe vetëm brenda periudhave javore ose mujore.

Nëpërmjet procesit të depozitimit/shkëmbimit, KESH sh.a depoziton/shkëmben tepërcat e energjisë të destinuara për shitje në tregun e lirë, me qëllim që:

- a) të maksimizojë prodhimin e energjisë elektrike nga kaskada dhe të optimizojë përdorimin e prurjeve për prodhim, për të evituar shkarkimet e ujit pa prodhuar energji elektrike dhe duke krijuar njëkohësisht rezervë energjie për periudhën e thatë të vitit;
- b) të garantojë në mënyrë të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve kontraktore;
- c) të rrisë fleksibilitetin teknik për të siguruar përmbushjen e detyrimit për shërbim publik;
- d) të minimizojë dhe/ose të parandalojë ndikimet potenciale social-mjedisore.

2.2 MASAT E MARRA PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS SË EMERGJENCËS

Gjendur në kushtet e një viti jo pozitiv hidrik dhe me energji me çmime të larta në tregje që ekspozojnë negativisht veprimtarinë e saj, Korporata e mbështetur dhe nën kujdesin e posaçëm të Qeverisë, ndërmorri hapa konkret për menaxhimin e situatës së krijuar, nëpërmjet plan-veprimit, si më poshtë:

- Blerje e energjisë në avancë, ku Shoqëria realizoi blerje në avancë të sasive të energjisë me qëllim garantimin e rezervës hidrike. Konkretisht Korporata parableu energji për muajin Mars në kapacitet prej 150 MW në profil bande, Prill- Qershor, kapacitet 50 MW, në profil bande;
- U realizua kontraktimi për qiramarrjen e aseteve gjenerues termik, në zbatim edhe të parashikimeve të VKM Nr. 620/2021, me qëllim garantimin e sigurisë në furnizimin me energji elektrike nga gjenerimi brenda vendit dhe ulje e ekspozimit në tregjet e energjisë. Në përfundim të procesit shoqëritë Exelerate Energy dhe Renco, u shpallen fituese për thirrjen e publikuar dhe vendosjen në zonën e Triportit (Vlorë) të aseteve gjenerues termik me kapacitet të instaluar prej 60 MW + 50 MW = 110 MW, duke rritur ndjeshëm kapacitetet shtesë të prodhimit të energjisë. Këto asete do të jenë të gatshëm për prodhim në periudha të thata, për të minimizuar ekspozimin ndaj importit me çmime dhe ndërkohë nëpërmjet hibridizimit të burimeve gjeneruese termo-hidro, ruan rezervën hidrike të kaskadës në këto periudha;
- U përmbyll procesi i ndërtimit të impiantit gjenerues fotovoltai në Digën e Qyrsaqit-HEC Vau i Dejës, me fuqi të instaluar prej 5.14 MW, i cili tashmë është aset operativ i Korporatës prej 12 Maj 2022. Ky impiant, i pari aset gjenerues i diversifikuar i energjisë për Korporatën, gjatë vitit 2022 prodhoi 4,203 MWh energji elektrike;
- U shfrytëzua, në kushtet e parablerjes së energjisë, rezervë energjitike e akumuluar në liqenin e HEC Fierzë. Përgjatë gjithë vitit, në zbatim të parashikimeve të VKM Nr. 620/2021 e ndryshuar dhe me tej VKM Nr. 456/2022, është realizuar nga ana e shoqërisë, depozitimi i energjisë tepërcë e prodhuar nga prodhuesit e vegjël hidrik në kontratë me FTL sh.a. Ky mekanizëm i ri u trajtua përgjatë vitit 2022, në veçanti në 3-mujorin e dytë, në kushtet e prurjeve mesatare ose nën mesatare në kaskadë, duke mundësuar gjenerim të shtuar në 3-mujorin e parë në raport me prurjet natyrore të këtij 3 Mujori.

- ▶ Intensifikimi i shkëmbimit marrje/dhënie të energjisë (veçanërisht me KEK), duke siguruar rezervë energjetike reciproke ndërmjet palëve në periudhat e nevojshme. Mekanizmi i depozitim/shkëmbimit u aplikua me KEK në zbatim të kontratës së shkëmbimit. Përgjatë vitit nga shoqëria KEK është tërhequr energji me qëllim kthimin duke ulur gjenerimin dhe rritur rezervën ujore në kaskadë. Një pjesë e rezervës energjetike u përdor gjatë muajit Mars 2022, me qëllim uljen e ekspozimit Korporatës në tregjet e energjisë përgjatë këtij muaji, duke qenë se muaji Mars paraqiti çmime shumë të larta të energjisë. Mjafton të përmendim që ky mekanizëm i ka siguruar rreth 4% energji KESH për plotësimin e DSHP-së.
- ▶ Pavarësisht masave të brendshme të marra, në përballimin e situatës të emergjencës, Qeveria e mbështeti Korporatën jo vetëm në përshtatjen ligjore/rregullatore por edhe në atë financiare, duke injektuar mbështetje financiare, për minimizimin e efekteve negative Konkretisht, bazuar në ligjin për buxhetin vitin 2022, i ndryshuar, u realizua Huadhenie ndaj KESH në vlerën 63 Mln. Eur dhe injektim kapitali financiar në vlerën 20 Mld. Lek (Akti Normativ Nr.3/2022). Masa këto të nevojshme dhe me ndikim në amortizimin e shpenzimeve të konsiderueshme për importin e energjisë me çmime të larta.

Si rezultat i masave të marra pavarësisht kostove të konsiderueshme por edhe me mbështetjen e Qeverisë, u arrit objektivi kryesor i përballimit të situatës së emergjencës, në plotësimin e DSHP-së, për sigurimin e energjisë për tregun e rregulluar, duke shfrytëzuar maksimalisht opsionet e parashikuara në ndryshimet e kuadrit ligjor/rregullator.

Përveç sigurimit të volumeve duhet theksuar që KESH u përqendra fort në menaxhimin e brendshëm sa më eficient të aktivitetit operues/shfrytëzues të aseteve gjeneruese në dispozicion minimizimin e efekteve negative në terma afatshkurtër me objektiv uljen e ekspozimit në tregje.

Korporata u kujdes maksimalisht në planifikimin, operimin dhe shfrytëzimin sa më eficient të rezervës hidriko-energjetike, për të maksimizuar prodhimin e brendshëm, por njëkohësisht duke mbajtur këtë rezervë në nivele sa më optimale, me qëllim minimizimin sa më shumë të jetë e mundur të importit nga tregjet me çmime të larta.

Konkretisht, situata hidrike në tërësinë a saj gjatë 2022, konsiderohet e përafërsisht e ngjashme me periudhat respektive të 2019 dhe 2020. Gjatë vitit 2022 janë prodhuar 822 GWh më shumë se prodhimi mesatar për periudhat respektive 2019 dhe 2020. E netuar kjo me diferencën prej -141 GWh ndërmjet rezervës energjetike mesatare 2022 me mesataren e rezervës energjetike për periudhat përkatëse 2019 dhe 2020, rezulton një prodhim i shtuar neto për 2022 prej 681 GWh.

Duke konsideruar që diferenca ndërmjet çmimit mesatar për energjinë sipas HUPX për 2022 dhe mesatares 2019-2020 është mbi 225 Eur/MWh, atëherë rezulton që efekti neto në rast se do të ishin importuar këto 681 GWh, do të ishte mbi 150 Mln. Eur. kosto shtesë.

Pra si rezultat e planifikimit dhe shfrytëzimit në gjenerim i kombinuar me operimin tregtar eficient, janë kursyer mbi 150 Mln. Eur, duke kontribuar ndjeshëm në uljen ndaj ekspozimit nga tregjet me çmime të larta dhe njëkohësisht duke mbajtur rezervën energjetike në HEC Fierzë në vlera optimale, e cila edhe si rezultat i situatës pozitive hidrike Nëntor-Dhjetor 2022, arriti në fund të 2022 në vlerën 1,193 GWh. Kjo përbën edhe një premisë pozitive për fillimin e 2023.

Po kështu, gjatë kësaj periudhe, vlen për tu theksuar se marrëdhënia KEK dhe KESH sh.a. ka arritur nivele shumë të mira bashkëpunimi. Tepricat e evidentuara nga shoqëria KEK sh.a. janë depozituar në KESH sh.a., në kuader të marrëveshjes shumëvjeçare të shkëmbimit të energjisë elektrike KEK-KESH. Gjatë vitit 2022, janë marrë nga KEK rreth 228 GWh, duke kontribuar në minimizimin e ekspozimit të KESH ndaj importit.

Balanca e mbetur me shoqërinë KEK sh.a. deri më 31 Dhjetor 2022 është 88,679 MWh, sasi kjo që do të kthehet shoqërisë KEK sh.a. gjatë periudhës së tepricave të energjisë elektrike.

2.3 PROGRAMI EKONOMIKO-FINANCIAR I KESH SH.A. PËR VITIN 2022

Keshilli Mbikqyrës i shoqërisë KESH sh.a. me vendimin Nr. 1, datë 19.01.2022, miratoi Programin Ekonomiko-Financiar fillestar vjetor të KESH sh.a. për vitin 2022. Miratimi përfundimtar i të cilit u bë nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve (MIE) me Vendimin Nr. 1349/1 date 16.02.2022.

Këto ndryshime ligjore dhe në përgjigje të situatës së emergjencës kombëtare, fokusuan Korporatën në aktivitet prioritar në tregun e rregulluar me përgjegjësinë publike për sigurimin e energjisë elektrike dhe furnizimin për konsumatorët tariforë të ndarë në dy nivele:

- Klientët tariforë të OSHEE/FSHU, që përfaqësojnë nivelin e tensionit 0.4 KV me çmim të rregulluar 2.6 Lek/kWh (pa TVSH);
- Klientët tariforë të FMF, që përfaqësojnë nivelin e tensionit 6/10/20 kV me çmim të rregulluar prej 12 Lek/kWh (pa TVSH);

Në volume fizike, detyrimi për DSHP llogaritet në mbi 5.7 TWh/vit. Plani prej 5.7 TWh u parashikua të përmbushet me 3.95 TWh energji prodhim të brendshëm dhe 1.75 TWh energji të importuar nga tregjet e energjisë, në mënyrë që të përballohet gjendja e emergjencës në furnizim dhe të mbrohet konsumatori duke mbajtur fiks çmimin final të energjisë elektrike. Si reflektim të përgjegjësisë dhe objektivave në situatë emergjence ngarkuar për Korporatën, në vijim paraqitet përmbledhtazi PEF i Miratuar i Shoqërisë:

Tabela 1. PEF i Miratuar 2022 i KESH sh.a.

(Shumat janë të shprehura në mijë lekë)	PL_PEF 2022 (i miratuar)
Operacionet e vijueshëm	
- Të ardhura nga shitja e energjisë:	28.679.292
<i>Shitjet e Energjise për klientët tariforë të OSHEE/FSHU</i>	12.040.154
<i>Shitjet e Energjise për klientët tariforë të FMF</i>	12.862.968
<i>Te ardhura nga faturim shtese FSHU</i>	0
<i>Shitjet e Energjise për mbulimin e humbjeve të OSHEE</i>	0
<i>Shitjet e Energjise për humbjet e Transmetimit OST</i>	0
<i>Shitje energjie elektrike për humbjet e Transmetimit KOSTT</i>	0
<i>Shitjet e Energjisë me çmime tregu dhe optimizim (eksport dhe tregu vendas)</i>	811.462
<i>Shitje Energjie për mbulimin e Disbalancave</i>	43.949
<i>Të Ardhura Shërbime ndihmëse për OST</i>	1.646.121
<i>Të Ardhura Shërbime ndihmëse për KOSTT</i>	1.270.242
<i>Të Ardhura te tjera energjie elektrike (Ashta+Noa)</i>	4.395
- Të ardhura të tjera operacionale	10.500
Shuma e të Ardhurave Operative	28.689.792
- Materiale të para dhe të konsumueshme	201.522
- Blerje Energjie:	21.433.117
<i>Blerje Energjie Elektrike me çmime tregu (import dhe tregu vendas)</i>	20.156.545
<i>Blerje Energjie Elektrike për optimizim (import dhe tregu vendas)</i>	994.952
<i>Kompesimi financiar për OSHEE për sasinë e energjisë të munguar</i>	0
<i>Tarifë Transmetimi</i>	6.758
<i>Blerje Energjie për mbulimin e Disbalancave</i>	155.652
<i>Blerje Shërbime ndihmëse OST</i>	119.211
<i>Blerje Shërbime ndihmëse KOSTT</i>	0
<i>Shpenzime te tjera energjie elektrike</i>	0
- Shpenzime personeli	1.382.201
- Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	3.610.810
- Shpenzime të tjera operacionale	1.152.115
Shuma e Shpenzimeve Operative	27.779.765
Fitimi Operativ	910.026
Të ardhura financiare	124.508
Shpenzime financiare	-678.048
Shpenzime Financiare Neto	-553.540
Fitimi para tatimit	356.486
Shpenzime tatim fitimi	-53.473
Fitimi neto i periudhës nga operacionet e vijueshëm	303.013

Për vitin 2022, detyrimi për shërbim publik ndaj shoqërisë FSHU është rregulluar nga dy akte, konkretisht VKM Nr. 620/2021, e ndryshuar dhe VKM Nr. 456/2022. Referuar këtyre akteve, aktiviteti operacional i Korporatës për 2022 në kushtet e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, përmbledhet në:

1. Mbulimi i te gjithë nevojës së FSHU sh.a. për plotësimin e DSHP-së, maksimalisht dhe me efikasitet nga prodhimi i brendshëm;
2. Nga Korrik 2022, mbulimi i energjisë për humbjet në transmetim ndaj OST sh.a. me çmimin e Prodhuesve nga burimet e rinovueshme;
3. Depozitimi i tepërcave të prodhuesve nga burimet e rinovueshme dhe shkëmbimi i tyre në periudhën e thatë të vitit ku prodhimi i BRE nuk mbulon humbjet.
4. Aktiviteti komercial i blerjeve të energjisë në tregun e parregulluar, por sa më pak i mundshëm, për të minimizuar volumet hyrëse importuese të shtrenjta, me objektiv ekspozimin sa më pak i mundshëm ndaj tregjeve të energjisë.

2.4 PËRMBLEDHJE E SITUATËS HIDRIKE

Viti 2022 është i ndarë në dy pjesë: në 8-mujorin e parë i cili ishte i thatë dhe 4-mujori i fundit me evente dhe prurje të konsiderueshme në krahasim me pjesën e parë të vitit 2022. Shkurtimisht 8-mujori i parë i vitit 2022 u karakterizua nga një situatë jo e favorshme hidrike dhe njëkohësisht mjaft sfiduese për shkak të situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, shkaktuar nga kriza globale e çmimeve të energjisë. Në tërësi treguesit hidrikë janë më të ulët jo vetëm me periudhën respektive të lagësht të 2021, por edhe treguesit mesatar shumëvjeçar 1993-2021. Në të kundërt 4-mujori i fundit 2018 ishte me evente dhe reshje mbi normën dhe u karakterizua nga mot i lagësht që ndikuan në rritjen e prurjeve në 3 liqenet e Kaskadës.

Referuar portofolit aktual të gjenerimit pothuajse 100% hidro, situata hidro-meteorologjike në aktivitetin operacional të prodhimit, merr rëndësinë kryesore në performancën e prodhimit të brendshëm. Aq më tepër kjo në kushtet e emergjencës së furnizimit me energji elektrike, ku menaxhimi sa më eficient i prodhimit dhe rezervës energjetike është thelbësor për të gjeneruar maksimalisht prodhim të brendshëm, që do të thotë, ulje të ekspozimit ndaj tregjeve me çmime të larta.

Fillimi i vitit 2022, u karakterizua nga reshje të pakta nën mesataren shumëvjeçare den në 55% më pak të cilat e vendosën shoqërinë në vështirësi për përmbushjen e detyrimit për shërbim publik dhe e ekspozuan edhe më shumë në tregjet e energjisë.

Në muajin Prill situata hidrike u permirësua si rrjedhojë e situatës meteorologjike me reshje dhe e prodhimit në situatën me prurje nga prodhuesit e burimeve të rinovueshme (FTL sh.a.).

Kjo solli që në fund të 3-mujorit të dytë, shoqëria të arrinte duke kombinuar dhe blerje energjie për periudhën, një rezerve hidrike prej mbi 1 TWh.

Bazuar në prodhimin faktik të periudhës Janar-Nëntor prodhimi bruto i energjisë elektrike për vitin 2022 rishikohet me ulje për një total prej rreth 3.6 TWh ose 0.37 TWh më pak kundërt planit të miratuar për vitin 2022. Si rrjedhojë prodhimi faktik si dhe importi i energjisë në tregje, duke patur parasysh administrimin e prurjeve do të rezultojë me ndryshime në krahasim me PEF të miratuar të vitit 2022.

Ndryshe nga viti 2021, ku pjesa e parë e vitit ishte e lagësht dhe pjesa dytë e thate, viti 2022 reflektoi të kundërtën, ku pjesa e parë e vitit ishte e thate dhe 4-mujori i fundit (sidomos eventet Nëntor-Dhjetor) ishte i lagësht. Pavarësisht përmirësimit të situatës hidrike në fund të vitit, sidomos periudha Nëntor-Dhjetor, i gjithë viti 2022, kategorizohet si vit jo i mirë hidrik, duke ekspozuar Shoqërinë ndaj rikut hidro-meteorologjik.


Shkurtimisht treguesit kryesorë të operim/shfrytëzimit të kaskadës së Drinit, jepen si në vijim:

- **Prurjet** mesatare të vitit 2022 janë mbi 172 m³/s, ose -26% më të ulta në krahasim me vitin 2021, që ishin rreth 233 m³/s. Kurse në krahasim me mesataren 20 vjeçare prej 181 m³/s janë 5 % më pak.
- **Niveli** mesatar i shfrytëzimit në Fierzë gjatë vitit 2022 rezultoi rreth 276 m, krahasuar me rreth 284 gjatë 2021, pra rreth 8 mmnd më i ulët.
- **Rezerva Energjetike** në fillim të vitit 2022 ishte 624 GWh ndërsa në fund të 2022 ishte 1,193 GWh. Gjatë vitit përveç prodhimit dhe administrimit të prurjeve është akumuluar edhe 569 GWh rezervë


energjetike. Rezerva Mesatare Energjetike mujore gjatë 2022 ishte 661 GWh fillim muaji ose 28% më e ulët se 2021 (922 GWh).

- **Prodhimi Bruto** total per vitin 2022 rezulton rreth 3,892 GWh ose -28% më i ulët ne krahasim me vitin 2021 qe rezultoi rreth 5,393 GWh. Ndërsa në krahasim me mesateren 20-vjecare e cila është rreth 4,291 GWh, prodhimi i 2022 rezulton 9 % më pak.

Grafiku 2. Rezerva Energjetike - 2022 vs 2021 (fillim muaji në GWh)



Grafiku 3. Prodhimi Bruto i Kaskadës 2022 vs 2021 (GWh)



Edhe grafikisht konstatohet qartë që në tërësi viti 2022 rezultoi më i thatë hidrikisht se 2021, duke sjellë edhe prodhim krahasimisht më të ulët. Gjithsesi nga grafiku i rezervës energjetike vërehet që Korporata ka ndjekur një administrim rigoroz e orientuar në drejtim të ruajtjes së rezervës energjetike, në kushtet e emergjencës në sektor.


2.5 TË DHËNAT KRYESORE OPERATIVE TË AKTIVITETIT TREGTAR DHE EKONOMIK

Pavarësisht vështirësive si pasojë e situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike gjatë vitit 2022, Korporata arriti të realizojë aktivitetin e saj operacional që konsiston në:

- Sigurimin e volumeve të energjisë elektrike për detyrimin për shërbimin publik;
- Ofrimin në kohë dhe me cilësinë e duhur të shërbimeve të balancimit dhe atyre ndihmëse;
- Aktivitet tregtar sa më dinamik, për të siguruar të ardhura nga aktiviteti në tregun e lirë, të cilat në kushtet e emergjencës dhe të një viti jo të mirë hidrik, të amortizojë sa më shumë efektin negativ të ekspozimit ndaj tregjeve;

Grafiku i mëposhtëm pasqyron volumet kryesore të aktivitetit të shitjes së energjisë dhe shkëmbimit, krahasuar me PEF të miratuar për 2022:

Grafiku 4. Shitje + Dhënie Energjie - Realizim 2022 vs PEF i Miratuar 2022 (MWh)




Referuar grafikut më lart, gjatë vitit 2022, vërehet qartësisht që fokusi i veprimtarisë operationale, në kushtet e emergjencës në furnizimin me energji, është përqëndruar në plotësimin e DSHP-së, e cila përbën 90% të aktivitetit të volumeve dalëse të energjisë. Korporata arriti plotësojë me sukses detyrimin për shërbimin publik, të zhvillojë një aktivitet tregtar për aq sa kanë lejuar kushtet hidrike, shkëmbim/dhënie energjie dhe të siguroj aktivitet thelbësor të shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit.

Si reflektim i situatës së emergjencës, aktiviteti operacional gjatë vitit 2022, i shprehur me shifra agregate, kishte si objektiv kryesor reagimin adekuat me qëllim plotësimin e DSHP-së, dhe minimizimin sa më shumë të jetë e mundur të ekspozimit ndaj tregjeve, për të ulur kostot e larta të importit.

Zërat kryesorë përgjithshme agregate dhe i krahasuar me PEF të miratuar fillestar 2021, pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 5. Të ardhura/Shpenzime - Realizim 2022 vs PEF i Miratuar 2022 (Mld. Lek)



Referuar grafikut më lart, shkurtimisht evidentohet:

- Të ardhurat nga aktiviteti energjistik janë rritur me 28% krahasuar me planin, ku 21.34 Mld. Lek ose 58% e totalit e përbejnë të ardhurat nga shitjet për DSHP;
- Shpenzimet nga aktiviteti energjistik janë rritur me 170% krahasuar me planin, ku 52.5 Mld. Lek ose 91% e totalit e përbëjnë shpenzimet e importit të energjisë elektrike, në një treg me çmime shumë të larta;
- Shpenzimet e Përgjithshme të Aktivitetit (Administrative + Amortizimi) janë ulur me 0.2 Mld. Lek ose -3% krahasuar me planin, duke rritur eficiencën dhe optimizimin e e kostove fikse të aktivitetit;
- Rezultati neto i operacioneve të vijueshëm të aktivitetit për 2022, është me humbje prej -25.8 Mld. Lek, imponuar plotësisht nga importi shumë i shtrenjtë si pasojë e krizës globale të energjisë.

2.6 KOMERCIALIZIMI I MËTEJSHËM I AKTIVITETIT

Tregu i energjisë po ndryshon me ritme të larta në krahasim me disa vite më parë. Në mbarë globin, qeveritë po vënë në zbatim politikat kundër emetimit të karbonit dhe gjatë 5 viteve të ardhshme, shumë shtete do të kenë implementuar disa politika për reduktimin e nivelit të karbonit.

Në Shqipëri po investohet kryesisht në ndërtimin e parqeve fotovoltaike si edhe është në hapat e para orientimi investues drejt prodhimit të energjisë nëpërmjet parqeve eolike. Strategjia e diversifikimit është plotësisht në përputhje me planet për zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri dhe bashkimin e tregut me Kosovën. Në rrafshin afatgjatë, pas bashkimit të tregut, pritet që burimet tona të qëndrueshme të energjisë, të jenë në gjendje të jene konkurruese në rajonin e Evropës Juglindore.

Në fokusin e strategjisë së Shqipërisë është zhvillimi i burimeve të qëndrueshme të energjisë dhe promovimi i investimeve në këtë fushë. Aktualisht Shqipëria është një vend që prodhon energji elektrike pothuaj 100 % nga burimet hidrike. Në këtë kontekst, diversifikimi i burimeve të energjisë elektrike, nëpërmjet burimeve fotovoltaike dhe ishte në fokus të strategjisë së Korporatës dhe për vitin 2022.

Me rritjen e kapaciteteve prodhuese, KESH-sh.a. do të diversifikojë portofolin e prodhimit të energjisë, i cili, deri më sot, është 100% i varuar nga burime hidrike, ndërsa në vitet e ardhshme, do të jetë një kombinim i burimeve hidrike, fotovoltaike dhe eolike.

Shtimi i diversifikuar i kapaciteteve të reja gjeneruese, duhet të ecë paralelisht me procesin e liberalizimit të tregut.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2022 është ecur me ritme të shpejta drejt implementimit të Bursës së Energjisë, në të cilën KESH-sh.a. do të ketë një rol kryesor përsa i përket formimit të çmimit në këtë bursë, e gjithashtu Shqipëria e Kosova do të bëhen një treg i përbashkët (market coupling).

Në Shqipëri do të implementohen akte e rregulla sipas standarteve Europiane, kjo, me qëllim për një operim sa më efikas në menaxhimin e flukseve të energjisë dhe konkretisht:

- OST sh.a. do të implementojë në sistemin e nominimeve programimin me 15 minuta të prodhimit e të tregtimit të energjisë elektrike;
- Rregullat REMIT, të cilat janë shumë strikte përsa i përket prodhuesve lidhur me planifikimin dhe prodhimin e energjisë elektrike.

Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike, është një nga objektivat që qeveria shqiptare synon, duke investuar në rrjetin e transmetimit e atë të shpërndarjes, me qëllim krijimin e infrastrukturës për daljen e konsumatorëve në tregun e lirë. Në vijim të këtij procesi, shoqërisë KESH-sh.a. do t'i ulet pesha e detyrimit për shërbim publik, duke krijuar mundësi optimale Korporatës që të komercializojë më tej aktivitetin e saj të furnizimit me pakicë për këtë kategori klientësh të cilët dalin në treg të parregulluar, kjo, në funksion të optimizimit të portofolit tregtar dhe rrjedhimisht, të maksimizimit të fitimit.

Duhet theksuar se në 2022 pati një risi në zhvillimin e procedurave të tregtimit të energjisë elektrike, pasi prej datës 8 Korrik 2022, Korporata implementoi platformën elektronike të shit-blerjes së energjisë Sistemi elektronik i ka mundësuar KESH që procesi i vlerësimit të ofertave të jetë shumë i shpejtë dhe transparent.

3. ÇËSHTJE LIGJORE/RREGULLATORE TË LIDHURA ME VEPRIMTARINË

Gjatë vitit 2022, zhvillimet kryesore të lidhura me këtë periudhë ushtrimore, fokusohen në përballimin e situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

Situata tashmë e njohur e rritjes globale të çmimit të energjisë që prej gjysmës së dytë të 2021 shënoi edhe fillimin e krizës energjetike në Europë dhe më gjerë si rezultat i rritjes disafish të çmimeve/njësi të tregtimit me shumicë të energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare, duke rritur të gjitha çmimet dhe tarifatat e tjera të energjisë elektrike, me influencë jo vetëm sektoriale por edhe me efekt zinxhir negativ në degët e tjera të ekonomisë, përballë një situatë ekonomike inflacioniste.

- Në përgjigje të kësaj situatë dhe ndërmarrjes së masave përkatëse, Këshilli i Ministrave, me **Vendimin nr.584, datë 08.10.2021**, shpalli gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike e cila i shtriu efektet deri në dt. 15 Prill 2022, duke vendosur ngritjen e grupit ndërinstitucional për menaxhimin e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, pezullimin e planeve të investimeve përveç atyre më të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë për shoqëritë “KESH sh.a.”, “OST sh.a.” dhe “OSHEE Group sh.a.”.

Nga ana tjetër, sipas këtij vendimi, këto shoqëri do të koordinojnë ushtrimin e aktivitetit, në përputhje me udhëzimet e MIE, me qëllim garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike.

Në vijim dhe zbatim të Vendimit nr.584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, Këshilli i Ministrave miratoi **Vendimin nr.620, datë 22.10.2021**, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe përballimin e parandalimit e saj”, me ndryshimin përkatës **Vendimin nr.757, datë 09.12.2021**.

Sipas këtij vendimi, FSHU-së, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga KESH sh.a. KESH sh.a furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

Për qëllime të furnizimit me të gjitha sasi të nevojshme për nevojat e FSHU-së, KESH sh.a. ka të drejtë të marrë me qira asete gjeneruese termike të energjisë, të shkëmbejë/të depozitojë apo të kryejë transaksione shitblerjeje energjie në tregun e lirë.

Sipas kësaj VKM, KESH sh.a. do të kryejë veprime shitje energjie dhe depozitimi/shkëmbimi vetëm pasi plotëson të gjitha nevojat e furnizimit të FSHU si edhe OSSH, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e saj.

Po sipas këtij vendimi, sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga KESH sha, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, i shitet OSSH për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit të shitjes së prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike nga burime hidrike, me kapacitet të instaluar deri në 15 MW, në periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet.

KESH sh.a. për menaxhimin e kaskadës dhe sigurimit të energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve të rregulluar kryen procedurat sipas këtij vendimi, për depozitimin e shkëmbimin e tepërcave të energjisë elektrike, vetëm pasi ka plotësuar nevojat e FSHU. KESH sh.a. ka të drejtë të bëjë optimizim financiar të kaskadës, vetëm në rastet kur nuk cenon sasi të nevojshme të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe vetëm brenda periudhave javore ose mujore.

Nëpërmjet procesit të depozitimit/shkëmbimit, KESH sh.a depoziton/shkëmben tepërcat e energjisë të destinuar për shitje në tregun e lirë, me qëllim që:

- a) të maksimizojë prodhimin e energjisë elektrike nga kaskada dhe të optimizojë përdorimin e prurjeve për prodhim, për të evituar shkarkimet e ujit pa prodhuar energji elektrike dhe duke krijuar njëkohësisht rezervë energjie për periudhën e thatë të vitit;
- b) të garantojë në mënyrë të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve kontraktore;
- c) të rrisë fleksibilitetin teknik për të siguruar përmbushjen e detyrimit për shërbim publik;
- d) të minimizojë dhe/ose të parandalojë ndikimet potenciale social-mjedisore.

Ky vendim i Këshillit të Ministrave i shtriu efektet për 6- mujorin e parë të vitit 2022.

- **Me Vendimin nr.256, datë 29.04.2022** “Për disa ndryshime në vendimin nr.584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, Këshilli i Ministrave vendosi të shtyjë gjendjen e emergjencës në sektorin e energjisë elektrike deri në datën 31 Dhjetor 2022 dhe në këtë mënyrë duke lënë në fuqi detyrimet e shërbimit publik dhe detyrime të tjera të përcaktuara për KESH sh.a me Vendimin nr.584/2021, me ndryshimet përkatëse. Po kështu në këtë vendim, shfuqizohet pezullimi planeve të investimeve në sektor, pasi pavarësisht situatës, zhvillimi strategjik i sektorit duhet të ecë përpara.
- **Me Vendimin nr.456, datë 29.06.2022**, Këshilli i Ministrave miratoi kushtet e reja për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike duke shfuqizuar kështu Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe nr. 620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përbalimin e parandalimit e saj”, të ndryshuar.

Ky vendim sjell ndryshime të rëndësishme në rolin dhe aktivitetin e KESH-it në tregun shqiptar të energjisë elektrike, veçanërisht në atë të rregulluar, duke fuqizuar rolin, por edhe përgjegjësitë e KESH-it, pasi rrit ndjeshëm detyrimin për shërbim publik të Korporatës në këtë situatë emergjence, me qëllim garantimin e furnizimit me energji elektrike për operatorët/pjesëmarrësit të cilët janë ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik dhe në këtë mënyrë për atë kategori konsumatorësh të cilët klasifikohen klientë fundorë dhe që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit.

Ky vendim filloi efektet për 6- mujorin e dytë të vitit 2022 e në vazhdim.

- **Me Vendimin nr.650, datë 10.10.2022** “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.584, datë 08.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, i ndryshuar, Këshilli i Ministrave ka vendosur të zgjasë gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri në datën 30 qershor 2023. Po me këtë vendim ka përcaktuar vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë FTL sh.a.. Kategorisë PPE i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike te shoqëria FTL, në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr.687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike. Ky ndryshim, kufizon tregun e lirë të energjisë elektrike por nga ana tjetër në këtë situatë emergjente rrit garancinë për furnizimin me energji elektrike të klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit dhe mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, veçanërisht në një situatë hidrologjike të karakterizuar nga reshje që sjell rritje të prodhimit të energjisë elektrike. Ky rregullim është me efekte pozitive për KESH-in pasi do të ulë detyrimin dhe peshën e Korporatës në drejtim të plotësimit të detyrimeve që i janë vendosur me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.456/2022.
- **Me Aktin Normativ Nr. 3, miratuar me Ligjin Nr. 31, date 31.03.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin Nr. 115/2021, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022”**, shoqërisë KESH sh.a., ju alokua një fond mbështetje buxhetore prej 20 Mld. Lekë.
Ndërsa me **Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 498, date 10.08.2022 dhe Nr. 603, datë 14.09.2022**, u bë i mundur për KESH sh.a.-në alokimi i fondit mbështetje buxhetore prej 20 Mld. Lekë, i parashikuar në buxhet me Aktin Normativ Nr. 3.

Ndërsa Bordi i Entit Rregullator të Energjisë gjatë 6- mujorit të parë të vitit 2022, miratoi disa vendime në lidhje me veprimtarinë e Korporatës, të përmbledhura si më poshtë:

- *Vendim nr. 03, datë 13.01.2022, i Bordit të ERE “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike i Digës Qyrmaq, HEC Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5.143 MWp.*
Në vijim të kërkesës së KESH sh.a. për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga Impianti Fotovoltaike i digës Qyrmaq, HEC Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5.143 MWp. Ky investim është kryer me fondet e veta të Korporatës në kuadër të investimeve në prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të saj. Me anë të këtij vendimi Bordi i ERE filloi procedurat në lidhje me këtë licencim.
- *Vendim nr. 62, datë 11.04.2022, i Bordit të ERE “Mbi licencimin e shoqërisë KESH sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike i Digës Qyrmaq, HEC Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5.143 MWp.*
Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s përmbylli procedurën e licencimit të KESH sh.a në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike i Digës Qyrmaq, HEC Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5.143 MWp dhe për një afat 25- vjeçar, procedurë kjo e nisur nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 3, datë 13.01.2022.
- *Vendim nr. 78, datë 13.04.2022, i Bordit të ERE “Mbi rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020”.*
Bordi i ERE-s, vendosi mbylljen e procedurës së nisur me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2021, “Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a., për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të

energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020”, duke vendosur gjithashtu që deri më datën 30 Shtator 2022, periudha kohore e proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 orë.

- Vendim nr. 124, datë 31.05.2022, i Bordit të ERE “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2022”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2022 duke përcaktuar gjithashtu që diferencat që rezultojnë nga pasyrat financiare të çertifikuara për vitin 2021, të konsiderohen në llogaritjen e pagesave të rregullimit të periudhës pasardhëse ndërsa të licencuarit subjekt i këtij vendimi duhet të kryejnë pagesat rregullatore ndaj ERE, jo më vonë se 30 ditë nga botimi në fletoren zyrtare i këtij vendimi.

Në kuadër të këtij vendimi të bordit të ERE-s, detyrimi i KESH sh.a në lidhje me pagesat rregullatore për vitin 2022 sipas të 3 (tre) liçensave të aktivitetit përkatësish të prodhimit, tregtimit dhe furnizimit, është në vlerën prej 29.786.124 lekë. Ndërsa TEC Vlora sh.a ka një detyrim pagese rregullatore për liçensë prodhimi prej 100.000 Lek.

- Vendim nr. 187, datë 21.07.2022 i Bordit të ERE “Mbi kualifikimin e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrzaqit, HEC “Vau i Dejës” i shoqërisë “KESH” sh.a.

Bazuar në “Rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 229, datë 20.12.2019, KESH sh.a. aplikoi në ERE për kualifikimin e impiantit fotovoltaik në Digën e Qyrzaqit në HEC “Vau i Dejës” si impiant gjenerues i energjisë së rinovueshme, kualifikim i cili u miratua me Vendimin në fjalë të bordit të ERE-s.

- Vendim nr. 220, datë 01.09.2022, i Bordit të ERE “Mbi miratimin e ndryshimeve në rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e liçencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s miratoi disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren e liçencimit, duke lehtësuar dokumentacionin përkatës për këtë qëllim si edhe ndryshoi tarifën e liçencimit. Vendimi sjell efekte në veprimtarinë e KESH-it i cili është në fazën e liçencimit si prodhues për disa impiante prodhimi.

- Vendim nr. 230, datë 12.09.2022, i Bordit të ERE, “Mbi miratimin e kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a dhe OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit për periudhën 02.07.2022 deri më 31.12.2022”

Neni 13, pika 1, e VKM-së nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, përcakton se: “Gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizim, shoqëria publike e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik/KESH sh.a, furnizon shoqërinë OST sh.a. me të gjithë sasinë e nevojshme, për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi hidrike. Kontrata ndërmjet 2 shoqërive negocohet nga palët dhe miratohet nga ERE”, shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a. negociuan kontratën përkatëse për periudhën kohore 02.07.2022- 31.12.2022 dhe e dërguan në Bordin e ERE-s, Bord i cili e miratoi këtë kontratë me vendimin nr.230/2022.

- Vendim nr. 242, datë 23.09.2022, i Bordit të ERE, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh në muaj”, me vendimet përkatëse ndryshuese.

Shoqëria FSHU sh.a., ka paraqitur mbi bazë mujore duke filluar nga muaji Tetor, në ERE, kërkesat për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për konsumin e energjisë elektrike mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë, për

arsye të rritjes së kostos së blerjes së energjisë elektrike që prokurohet për qëllime të mbulimit të nevojës së FSHU sh.a., nga shoqëria KESH sh.a, mbështetur në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 6645/1, datë 08.09.2022 në të cilën është vendosur që çmimi për energjinë e klientëve familjarë për konsumin mbi 800 kWh/muaj të jetë 34.3 Lekë/kWh.

Por pavarësisht këtyre aplikimeve, Bordi i ERE ka shtyrë në mënyrë të vazhdueshme aplikimin e tarifës mbi konsumin mujor 800 kWh/muaj e për rrjedhojë kjo s'ka gjetur zbatim gjatë 3-mujorit të fundit të vitit 2022.

- Vendim nr. 246, datë 29.09.2022, i Bordit të ERE "Mbi kërkesën e OST sh.a. për zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 2 të vendimit të ERE nr. 78, datë 13.04.2022".

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE vendosi që periudha kohore e proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore deri në datën 31 Mars 2023.

- Vendim nr. 247, datë 29.09.2022, i Bordit të ERE "Mbi licencimin e "Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX" sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike".

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi të licencojë shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX" sh.a., në aktivitetin e operimit të tregut të energjisë elektrike, për një afat 5 – vjeçar.

- Vendim nr. 347, datë 27.12.2022 i Bordit të ERE "Mbi për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e alpeX përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)

Me këtë vendim, Bordi i ERE miratoi paketën e Rregullave të Funkcionimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike/ALPEX, paketë e cila përfshin: 1- Përkufizimet e ALPEX, 2- Procedurat e Klerimit dhe të Shlyerjes, 3- Procedurat e Tregtimit, 4- Rregullat e ALPEX – Termat e përgjithshme.

- Vendim nr. 337, datë 21.12.2022, i Bordit të ERE, "Mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për shitjen/ blerjen/ depozitimin/ shkëmbimin e energjisë elektrike".

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për shitjen/ blerjen/ depozitimin/ shkëmbimin e energjisë elektrike ndërmjet tyre sipas përcaktimeve të vendimit nr.456, datë 29.06.2022, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike".

Sipas kësaj kontrate, sasia e tepërt e energjisë elektrike nga prodhimi i Kaskadës së Drinit, pas ezaurimit të sasisë së energjisë së depozituar nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në periudhat pararendëse, i shitet shoqërisë FTL sh.a. nga KESH-i për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga Prodhuesit me Përparësi. Gjithashtu sipas kontratës transaksionet e depozitimit dhe shkëmbimit të energjisë elektrike që rezultojnë si diferencë (përkatesisht pozitive dhe negative) ndërmjet shumatores së prodhimit nga burimet e rinovueshme të energjisë dhe blerjes në treg të parregulluar për mbulimin e humbjeve, me humbjet totale mujore në rrjetin e shpërndarjes, do të realizohen pa çmim por me bilance energjetike dhe në raportin 1 (një) njësi e depozituar / 1 (një) njësi e kthyer.

- Vendim nr. 338, datë 21.12.2022, i Bordit të ERE-s "Mbi miratimin e "kontratës tip për shit- blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a."

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për furnizimin me energji elektrike të klientëve fundorë që furnizohen nga FSHU-ja,

sipas përcaktimeve të vendimit nr.456, datë 29.06.2022, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe me çmimet e miratuara nga Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë KESH sh.a.

- Vendim nr. 350, datë 28.12.2022, i Bordit të ERE-s, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në gjirin e Vlorës, me fuqi të instaluar 110 MW”.

Në kuadër të detyrimeve për garantimin e energjisë elektrike për përmbushjen e plotë të kërkesës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal, të përcaktuara me aktet nënligjore, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.620/2021, shoqëria KESH sh.a. lidhi një kontratë qeraje me shoqërinë “Exelerate Global Operations” Ll.C dhe shoqërinë “Renco” S.P.A, për një periudhë 2- vjeçare për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti i gjeneruesve termik lundruar Tiger 1 dhe Tiger 3, përkatësisht me fuqi të instaluar 60 MW dhe 50 MW dhe lidhur me këtë, KESH sh.a. nisi aplikimin në ERE për licencimin për prodhimin nga ky impiant. Në këtë kuadër, Bordi i ERE-s filloi me anën e këtij vendimi procedurën përkatëse për licencimin.

4. AKTIVITETI PRODHUES, MIRËMBAJTËS DHE EFIÇENCA NË SHFRYTËZIM

4.1 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE – OPERIMI

Në lidhje me situatën hidrike, 8 mujori e parë viti 2022 u karakterizua nga një situatë jo e favorshme hidrike dhe njëkohësisht njaft sfiduese për shkak të situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, shkaktuar nga kriza globale e çmimeve të energjisë. Në tërësi treguesit hidrikë janë më të ulët jo vetëm me vitet e lagësht 2018 dhe 2021, por edhe treguesit mesatar shumëvjeçar 1993-2021.

Sipas treguesve hidrik viti 2022, rezultoi lehtësisht më pozitiv, krahasuar me vitet e thata 2019 dhe 2020. Thatësira e zgjatur dhe mungesa e reshjeve në 8 mujorin e parë rezultuan në prurje mesatare në liqenin e Fierzës prej rreth 141 m³/s, përkatësisht 51% më pak se në 8 mujorin e parë të vitit 2021 me prurje prej 287 m³/s dhe 28% më pak se mesatarja shumëvjeçare 1993-2021 prej 195 m³/s.

Në ndryshim nga 8 mujori i parë, 4 mujori i fundit u karakterizua nga mot i lagësht me reshje dhe prurje të konsiderueshme në 3 liqenet e kaskadës. Gjatë këtij 4 mujori, prurjet në liqenin e Fierzës ishin rreth 237 m³/s në krahasim me prurjet mesatare prej 125 m³/s gjatë së njëjtës periudhë në 2021.

Në tërësi, prurjet mesatare të vitit 2022 ishin rreth 172 m³/s ose 26% më pak se në vitin 2021 me rreth 233 m³/s dhe 5% më pak se mesatarja shumëvjeçare prej 181 m³/s.


Tabela 2. Prurjet dhe prodhimi 2022 vs Mesatarja Shumëvjeçare

Prurjet dhe Prodhimi	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Mesatarja 15 vjeçare
Prurjet në Fierzë (m ³ /sek)	172	233	119	121	235	131.08567	181
Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)	95.4%	129.0%	65.9%	67.0%	130.1%	72.6%	
Prodhimi Bruto i Kaskadës (GWh)	3,892	5,393	3,121.2	3,010	5,902	2,945.0	4,306
Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)	90.4%	125.2%	72.5%	69.9%	137.0%	68.4%	

Shënim: Mes. 15 vjeçare i referohet viteve 2007-2021

Rrjedhimisht, situata hidrike u reflektua në prodhimin bruto total prej rreth 3,892 GWh, 28% më pak se në vitin 2021 prej rreth 5,393 GWh dhe 9.6% më pak se mesatarja shumëvjeçare prej 4,306 GWh.


Grafiku 6. Prurjet dhe prodhimi gjatë vitit 2022 vs Mesatarja Shumëvjeçare



Niveli në liqenin e Fierzës me datë 21 Dhjetor rezulton në kuotën 291.92 mmnd, rreth 17.96 m më shumë se në vitin 2021 në kuotën 273.96 m dhe 14.94 m më shumë se niveli mesatar 20 vjeçar për muajin Dhjetor në kuotën 276.98, si pasojë e reshjeve dhe rrjedhimisht prurjeve të shumta sidomos gjatë muajve Nëntor dhe Dhjetor.

- Niveli mesatar i shfrytëzimit në Fierzë gjatë vitit 2022 rezulton rreth 276 m, rreth 8 mmnd më i ulët krahasuar me vitin 2021.

Grafiku 7. Prurjet në Fierzë dhe Niveli Mesatar i Shfrytëzimit për 2022




Rezerva Energjetike në fillim të vitit 2022 ishte 624 GWh, ndërsa në fund të 2022 ishte 1,193 GWh. Gjatë vitit, përveç prodhimit dhe administrimit të prurjeve, është akumuluar edhe 569 GWh rezervë

energjetike. Rezerva Mesatare Energjetike gjatë vitit 2022 ishte 661 GWh ose 28% më e ulët se në vitin 2021 me rreth 922 GWh.

- Referuar Grafikut të mëposhtëm, shihet qartë se kushtet jo të favorshme meteorologjike në 8 mujin e parë ndikuan negativisht si në Rezervën Energjetike ashtu edhe në Prodhimin Mesatar Mujor, ku në muajt Janar-Gusht Rezerva Energjetike ishte rreth 22.4% më e ulët se mesatarja shumëvjeçare (1990-2021) dhe Prodhimi Mesatar Mujor ishte 15.2% më i ulët se mesatarja shumëvjeçare (1990-2021).

Grafiku 8. Prodhimi dhe Rezerva Energjetike gjatë vitit 2022



- Referuar grafikut të mëposhtëm, vërejmë një ngarkesë mesatare të agregateve lehtësisht më e lartë krahasuar me vlerat shumëvjeçare dhe konsumi i ujit/kWh të prodhuar mbetet në tërësi po i njëjti. Niveli mesatar i shfrytëzimit në Fierzë ishte 276.25 m, ose 5.63 m më i ulët se mesatarja shumëvjeçare prej 281.88 m, ndërsa në HEC Koman dhe Vau i Dejës ky tregues mbetet thuajse i njëjtë me mesataren shumëvjeçare. Kjo justifikon më së miri programimin eficient të regjimit operacional të kaskadës në një vit të vështirë hidrik si 2022, ku liqeni i HEC Fierzë ka rolin parësor të rregullatorit dhe depozituesit të rezervës energjetike, ndërkohë dy HEC-et e tjerë dhe sidomos Koman si HEC me fuqinë më të madhe të instaluar, kanë rolin parësor të prodhimit të energjisë.

Tabela 3. Eficienca në Gjenerim gjatë vitit 2022 krahasuar me mesataren shumëvjeçare

Eficienca në Gjenerim		Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Mesatarja 15 vjeçare
HEC Fierza	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	4.09	3.98	4.09	4.04	3.79	4.16	3.91
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	276.25	283.88	279.40	277.03	285.75	274.83	281.88
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	86%	86%	85%	83.5%	87.0%	86.1%	80%
HEC Koman	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	4.20	4.19	4.19	4.23	4.17	4.14	4.19
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	172.14	172.33	172.38	171.65	172.82	172.95	172.26
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	76%	79%	76%	76.4%	71.9%	65.0%	71%
HEC Vau i Dejës	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	8.48	8.49	8.28	8.45	8.48	8.52	8.46
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	73.70	73.90	73.81	74.04	74.30	73.91	74.10
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	86%	77%	77.7%	84.9%	83.4%	78.9%	80%

Shënim: Mes. 15 vjeçare i referohet viteve 2006-2021

Tabela 4. Krahasimi i prodhimit dhe efijencës në vite të ngjashme meteorologjike

Efienca në Gjenerim		2022	2020	2019	2017	2007	2001
HEC Fierza	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	4.09	4.09	4.04	4.16	4.37	4.28
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	276.25	279.40	277.03	274.83	268.12	270.25
	Energji e Prodhuar (GWh)	1,101	984	850	880	691	886
HEC Koman	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	4.20	4.19	4.23	4.14	4.24	4.25
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	172.14	172.38	171.66	172.96	170.80	170.36
	Energji e Prodhuar (GWh)	1,855	1,429	1,427	1,376	1,204	1,525
HEC Vau i Dejës	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	8.48	8.28	8.45	8.52	8.48	8.50
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	73.70	73.81	74.04	73.91	74.00	73.91
	Energji e Prodhuar (GWh)	936	708	733	689	632	775
Prodhimi i Kaskadës (GWh)		3,892	3,121	3,010	2,945	2,528	3,187

- Grafiku i mësipërm pasqyron krahasimin e efijencës dhe prodhimit në vite të ngjashme meteorologjike. Vërehet efijencë e shtuar e prodhimit të kaskadës në raport me konsumin e ujit për njësi të prodhuar. Marrë në tërësi për të 3 HEC-et, ky konsum është më i ulët në vlerë absolute me mesataren e konsumit të viteve të ngjashme meteorologjike.
- Referuar grafikut të mëposhtëm, për shkak të situatës së pafavorshme hidrike gjate muajve të parë të vitit 2022, ku prurjet mesatare natyrale në kaskadën e Drinit ishin 310 m³/s (rreth 20% më të ulëta se në vitin 2021), u arrit të prodhohej një sasi prej 3,892 GWh dhe u ruajt rezerva mesatare energjetike prej 709 GWh (7.4% më e ulët se mesatarja 15 vjeçare e rezervës energjetike). Po kështu, veçojmë ruajtjen e nivelit të Fierzës në kuota optimale, i cili në fillim të muajit Korrik 2022 rezultoi në vlerën 287.97 m (rreth 2.4 m më i ulët se niveli mesatar 15 vjeçar referues prej afërsisht 290.36 m), ndërsa në fillim të Dhjetorit rezultoi në kuotën 291.67 m (12.4 m më lartë se niveli mesatar 15 vjeçar referues prej 279.28 m).

Tabela 5. Shfrytëzimi dhe Menaxhimi i Prurjeve Natyrale në Kaskadën e lumit Drin (Analizë krahasuese për vite me situatë të ngjashme hidrike)

Treguesit për vitet	2022	2020	2019	2017	2007	2001	Mesatarja 15 vjeçare	2022 vs Mesatarja 15 vjeçare
Niveli në Fillim Janar (mmnd)	275.13	275.59	266.18	281.62	256.18	252.12	278.02	-2.89%
Niveli në Fillim Korrik (mmnd)	287.97	291.66	292.73	272.32	274.81	283.83	290.36	-2.39%
Niveli në Fillim Dhjetor (mmnd)	291.67	268.69	273.17	268.90	275.8	263.24	279.28	12.39%
Rezerva Mesatare Energjetike (GWh)	709.00	746.40	676.60	615.70	452.40	501.00	766.0	92.6%
Prodhimi (GWh)	3,892	3,121	3,010	2,945	2,528	3,187	4,306.2	90.4%
Prurjet Mesatare Natyrale në Drin (m ³ /sek.)	310	207	221	216	215	223	301	103.0%
Shkarkimet nga Tërbet Fierze (milion m ³)	0	0.0	0.0	0.0	0	0.0	191	0.0%
Shkarkimet nga Tërbet Koman (milion m ³)	222	85.8	24.3	72.5	0	0.0	648	34.2%
Shkarkimet nga Porta Vau Dejës (milion m ³)	361	172.6	0.0	52.2	0	0.0	865	41.7%
Kapacitetet Gjeneruese në dispozicion (MW)	1,151.0	1,160.0	1,226.0	1,132.0	1,141.0	1,221.0	1,217.0	94.6%

Shënim: Mesatarja 15 vjeçare i referohet viteve 2007-2021

Të gjithë treguesit e mësipërm tregojnë për një programim operimi racional/efiçent dhe nën monitorim të kujdesshëm për të mbajtur në ekuilibër optimal variablat Prurje-Nivel- Rezervë Energjetike-Prodhim. Megjithëse në kushte jo të favorshme hidrometeorologjike, Korporata arriti të maksimizojë furnizimin me energji për detyrimin ndaj shërbimit publik, si dhe të sigurojë shërbimet ndihmëse dhe të balancimit si palë përgjegjëse për këtë shërbim, duke minimizuar sa më shumë efektet negative që sjell një vit i thatë hidrik dhe uljen e ekspozimit ndaj importit.

4.2 SIGURIA E VEPRAVE HIDROTEKNIKE

Në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Rregullorja e Përgjithshme e Punës në KESH sh.a., Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”, VKM-së Nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”, KESH sh.a., edhe gjatë viti 2022 ka realizuar në mënyrë sistematike monitorimin e gjendjes teknike dhe sigurisë së 6 (gjashtë) digave të kaskadës së lumit Drin në të tre HEC-et e kësaj kaskade që janë nën administrimin e KESH sh.a.

Bazuar në kërkesat e mësipërme lidhur me sigurinë e veprave hidroteknike, janë realizuar monitorimet dhe matje në objektet përkatëse të digave, sistemeve të shkarkimit, veprave të marrjes së ujit si dhe tek masivët rrëshqitës. Në bazë të rezultateve të matjeve dhe vrojtimeve të mësipërme është realizuar përpunimi i të dhënave si dhe analiza, interpretimi dhe raportimi i tyre në mënyrë periodike (çdo muaj), si dhe pasqyruar në Raportin Vjetor të Shfrytëzimit, Monitorimit dhe Sigurisë së Digave.

Për kontrollin dhe monitorimin e digave, informacioni i përpunuar është përftuar nga sistemet e monitorimit të instaluar në kaskadë, sikurse janë:

1. Sistemi i Monitorimit Gjeologjik

Është bërë i mundur upgradi i Sistemeve të Monitorimit gjeologjik në HEC-et e Fierzës, Komanit dhe Vau Dejës.

2. Sistemi i Monitorimit Gjeodezik

Për monitorimin gjeodezik të digave të kaskadës kryhet monitorimi i rrjetit gjeodezik i përbërë nga reperë gjeodezik, monumentet gjeodezike, pika e referimi, pika nivelacioni.

3. Sistemi i Monitorimit Hidrologjik

Matjet kryhen në mënyrë automatike dhe transmetimi i të dhënave kryhet në kohë reale. Sektori që kryen këtë monitorim përgjatë vitit 2021 ka qenë pjesë integrale e DOP por që ka vazhduar të mbajë me informacion edhe DVHT.

4. Sistemi i Monitorimit Sizmik

Transmetimi i të dhënave kryhet online nga HEC-et në Drejtorinë e Sigurisë së Digave dhe për eventet në raste tërmetesh njoftimet vijnë në kohë reale në DVHT. Është bërë i mundur upgradi i Sistemeve të Monitorimit sizmik në HEC-et e Fierzës, Komanit dhe Vau Dejës.

5. Sistemi i Monitorimit të Filtrimeve

Rezultatet e monitorimeve hidro-teknike kanë përcaktuar edhe aktivitetet prioritare për mirëmbajtjen dhe/ose rehabilitimin e tyre. Punimet civile për mirëmbajtjen e veprave hidroteknike konsistojnë jo vetëm në punime të zakonshme të mirëmbajtjeve dhe riparimeve, por edhe në investime themelore.

4.3 MIRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I AGREGATEVE

Gjatë vitit 2022 Drejtoria e Mirëmbajtjes është përqendruar në përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit teknik të mirëmbajtjes elektromekanike të aggregateve dhe pajisjeve në tre hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin, duke harmonizuar mirëmbajtjen e planifikuar periodike me mirëmbajtjen e bazuar në kushtet e pajisjeve (Condition Based Maintenance) nga sistemet online të monitorimit, mbështetur me investime elektromekanike për upgrade/rinovime të plota teknologjike të sistemeve ekzistuese.

Objekti kryesor i Mirëmbajtjes gjatë vitit 2022 është mbajtja në gatishmëri e kapaciteteve gjeneruese, nëpërmjet diagnostikimit në kohë shoqëruar me shërbime efektive mirëmbajtjeje të aggregateve, investime efektive në pajisjet dhe sistemet elektro-mekanike të rëndësishme të aggregateve, duke parandaluar avaritë e defektet apo minimizuar numrin e tyre, si dhe mbajtja në gatishmëri të vazhdueshme e pajisjeve të veprave të shkarkimit të plotave.

Ndër investimet e natyrës mirëmbajtëse/ekzistuese apo rinovuese/investuese, më kryesoret përmendim:


1. Zbatimi i projektit të kontratës së rehabilitimit me rinovim teknologjik të 5 kushinetave mbështetëse HEC Vau i Dejës ku gjate 2022 u përfunduan punimet në AG1 dhe AG3;
2. Rehabilitimi elektro-mekanik i vinçit 2x10 ton në bjeftin e poshtëm në HEC Fierzë;
3. Rinovimi i sistemit të mbrojtjeve për 2 agregate me vendosje/konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë;
4. Ndërhyrje për Mirëmbajtjen e Sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman.

Tabela 6. Mirëmbajtja e Hidro-Agreateve 2017-2022

Treguesit e Mirëmbajtjes	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Mesatarja 10-Vjeçare
Orët e Punës së Agregateve (OP)	52,035	64,622	40,302	39,324	69,377	37,746	53,260.0
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	97.7%	121.3%	75.7%	73.8%	130.3%	70.9%	
Orët e Agregateve në Avari (OA)	100	66.8	38.2	6	49	51	99
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	101.0%	67.5%	38.6%	6.1%	49.5%	51.8%	
Koeficienti i Gadishmërisë së Agregatëve (OP/OP+OA, %)	99.81	99.90	99.91	99.98	99.93	99.86	99.82
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	99.99%	100.08%	100.09%	100.16%	100.11%	100.04%	
Rastet e Avari-Difekteve (RAD)	36	33	14	6	39	41	45
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	80.0%	73.3%	31.1%	13.3%	86.7%	91.1%	
Orë Pune ndërmjet Difekteve (OP/RAD)	1,445	1,958	2,879	6,554	1,779	920	1,701
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	85.0%	115.1%	169.3%	385.3%	104.6%	54.1%	

Shenim: Mes. 10 vjeçare i referohet viteve 2012-2021

Grafiku 9. Treguesit e Mirëmbajtjes së Sistemeve Hidroenergjetike 2017-2022



Në Hidrocentralet e kaskadës së Drinit zbatohen planet e integruara dhe të koordinuara të remonteve kapitale, remonteve të mesme dhe ato profilaktike të njërive prodhuese, të pajisjeve të veprave të shkarkimit si dhe të pajisjeve ndihmëse.

Për 2022 treguesit e mirëmbajtjes vijnë të përmirësohen krahasuar me mesataren e 10 (dhjetë) viteve të fundit. Performanca e mirëmbajtjes është përmirësuar si rrjedhojë e gatishmërisë së lartë të njërive për operim, efikasitetit të kontrolleve të vazhdueshme parandaluese, shërbimeve cilësore të mirëmbajtjes gjatë remonteve profilaktike e të mesme, si dhe investimeve për rinovime teknologjike të tyre e pajisjeve të tjera në tre HEC-et e kaskadës së Drinit.

Ndër treguesit e performancës për vitin 2022 krahasuar me 10 vjeçarin mund të përmendim:

- Orët e ndërprerjeve për shkak të anomalive kalimtare kanë qenë 100, ose 1% më shumë se mesatarja 10 vjeçare.
- Numri i avarive/defekteve ka qenë 36, ose 20% më pak se mesatarja 10 vjeçare.
- Koeficienti i gatishmërisë së agregateve është në vlerën 99.81%, afërsisht i njëjti me mesataren 10 vjeçare.
- Orët e punës ndërmjet Avari-Difekteve ishin 1,445, ose 15% më pak se mesatarja 10 vjeçare.

Për të gjitha rastet e avarive në njësitë e prodhimit të tre HEC-ve të kaskadës së Drinit, asnjëherë ndalimi i tyre nuk ka rezultuar me kohëzgjatje që imponojnë remonte të parakohshme për riparime kapitale. Është e rëndësishme të theksohet që rritja e gatishmërisë ndikon direkt edhe në shkallën e efikasitetit dhe cilësinë e prodhimit.

4.4 CILËSIA E PRODHIMIT

Hidrocentralet e kaskadës mbi lumin Drin (HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës) kanë në funksion sistemet e rregullimit automatik të frekuencës dhe të tensionit që garantojnë cilësinë e energjisë elektrike të prodhuar, duke përbushur në këtë mënyrë kërkesat e kodit të rrjetit.

KESH sh.a., ka përbushur kërkesat e kodit të rrjetit të transmetimit dhe kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, dhe tashme në të gjitha njësitë gjeneruese të secilës njësi prodhimi kemi të instaluar:

1. Sistemet statike dixhitale të rregullimit automatik të tensionit të gjeneratorëve (AVR).
2. Sistemet dixhitale të rregullimit automatik të shpejtësisë së turbinave.

Të gjithë sistemet e sipërpërmendura operohen dhe mirëmbahen nga DM dhe sektorët e mirëmbajtjes në të tre njësitë gjeneruese të Korporatës duke siguruar në këtë mënyrë:

- a. cilësi dhe parametra bashkëkohore për rregullimin e tensionit/fuqisë reaktive në dalje të njërive gjeneruese.
- b. cilësi dhe parametra bashkëkohore për rregullimin primar dhe sekondar të frekuencës/fuqisë aktive në dalje të njërive gjeneruese.
- c. rritje të qëndrueshmërisë statike dhe dinamike të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar si rrjedhojë e amplifikimit të lartë dhe të stabilizimit të lëkundjeve të sistemit nga sistemet e rregullimit automatik të tensionit të gjeneratorëve me AVR dhe PSS.
- d. siguri dhe gatishmëri e lartë në operimin e njërive gjeneruese.
- e. rritje të siguri dhe besueshmërisë së prodhimit të energjisë/furnizimit të vendit.
- f. të ardhura më të larta për shoqërinë nga shitjet e energjisë elektrike dhe shërbimeve ndihmëse.

5. BILANCI ENERGJETIK DHE AKTIVITETI TREGTAR PËR VITIN 2022

Në panoramën makro, nevoja për energji elektrike në Shqipëri është rritur me një ritëm shumë të lartë krahasuar me disa vite më parë. Aktualisht Shqipërisë i nevojiten rreth 6,000,000 MWh për furnizimin e klientëve universale, krahasuar me rreth 5,000,000 MWh që nevojiteshin më parë.

Duhet theksuar që viti 2022, si pasojë e niveleve të larta të çmimeve globale të energjisë elektrike, diktoi situatën e emergjencës kombëtare në furnizimin me energji elektrike. Kjo situatë, në shumë aspekte dhe për arsye të mbrojtjes së konsumatorit nga rritja e çmimit të energjisë, frenoi ecurinë normale të liberalizimit të tregut, duke kthyer përkohësisht elementë të liberalizuar të tregut në gjendje të tregut të rregulluar dhe me prioritet absolut sigurimin e energjisë. Korporata, si lojtar kryesor i prodhimit dhe tregtimit të energjisë, bazuar edhe në ndryshimet ligjore/rregullatore, fokusoi aktivitetin në sigurimin e plotë të energjisë elektrike për konsumatorët e tregut të rregulluar. Si rezultat, viti 2022, për KESH do të konsiderohet si i veçantë në kuptimin komercial, për shkak të këtij obligimi.

Në kushtet e mësipërme, Korporata duke shtuar edhe situatën jo të favorshme hidrike u gjend këtë vit përpara nevojës për të blerë sasi të munguara/paplotësuar nga rezerva energjitime e kaskades së Drinit, në tregun e lirë dhe me çmime të diktuar nga Bursat e Rajonit.

5.1 ANALIZA E BILANCIT ENERGJETIK

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet bilanci energjetik i volumeve të energjisë për vitin 2022:

Tabela 7. Bilanci Energjetik për vitin 2022 (MWh)

Treguesit	Viti 2022 (PEF i Miratuar)	Viti 2022 (Fakt)	Viti 2022 (Fakt-PEF) (Sasi)	Viti 2022 (Fakt- PEF) (%)
Sasia kontraktuale sipas shifës së vendosur nga MIE me Vendim Nr.1349/1, datë 16/02/2022 (PEF KESH sh.a. 2022-2026)	5.702.743	5.690.689	-12.054	-0,21%
Prodhimi neto KESH	3.950.000	3.859.730	-90.270	-2,29%
Shkëmbimi KESH / marrje	0	228.876	228.876	100,00%
Kontrate Depozitim-Shkëmbim VKM 620 - 2021 / marrje	0	0	0	0,00%
Blerje energjie me çmime tregu (import + tregtarë vendas, VKM 757-21)	1.752.743	1.460.962	-291.781	-16,65%
Blerje energjie për optimizim (import + tregtarë vendas)	60.000	6.772	-53.228	-88,71%
Marrje depozitim nga FTL	0	652.472	652.472	100,00%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	84.000	127.812	43.812	52,16%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	0	0	0	0,00%
Disbalanca negative KESH	6.000	11.404	5.404	90,06%
ASHTA Devijim pozitiv	0	4.635	4.635	100,00%
Total energji për tregtim nga KESH + shkëmbim	5.852.743	6.352.663	499.920	8,54%
Shitje FSHU/OSIHEE - klientë tariforë	4.630.829	4.624.275	-6.553	-0,14%
Shitje FMF - klientë tariforë	1.071.914	1.066.414	-5.500	-0,51%
Shitje OSIHEE humbje	0	0	0	0,00%
Shitje OST humbje	0	90.888	90.888	100,00%
Shitje KOSTT humbje	0	0	0	0,00%
Kthim borxhi shoqërisë FTL, ne zbatim te VKM 456/2022	0	113.116	113.116	100,00%
Shkëmbimi KESH / dhënie	0	135.965	135.965	100,00%
Kontrate Depozitim-Shkëmbim VKM 620 - 2021 / dhënie	0	1.920	1.920	100,00%
Shitje me çmime tregu (eksport + tregtarë vendas)	0	194.536	194.536	100,00%
Shitje energjie për optimizim(eksport + tregtarë vendas)	24.000	7.480	-16.520	-68,83%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	60.000	66.011	6.011	10,02%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	36.000	15.987	-20.013	-55,59%
Disbalanca pozitive KESH	24.000	31.484	7.484	31,18%
ASHTA Devijim negativ	6.000	4.587	-1.413	-23,55%
Total energji e tregtuar nga KESH + shkëmbim	5.852.743	6.352.663	499.920	8,54%
Disbalanca energjie për t'u verifikuar nga Operatori i Tregut (OST)	0	0	-0	0%


• **Energji e Prodhuar + Blerje (Disponibël për Tregtim):**

- Referuar tabelës së treguesve në volume të bilancit energjetik për 2022, rezulton që prodhimi neto ka qenë në sasinë rreth 3,86 TWh dhe vetëm -2.3% nga parashikimi. Konsiderohet një rezultat shumë i mirë krahasuar me parashikimin dhe vitin relativisht të thatë.
- Energji e blerë në treg të lirë/import 1.46 TWh, ose rreth -17% nga plani, duke arritur sadopak uljen e ekspozimit ndaj importit me çmime të larta.
- Marrje depozitim nga FTL për mbullim humbje në shpërndarje prej 652.47 GWh, referuar VKM nr. 456; dt. 29.06.2022.
- Blerje energjie për optimizim portofoli ku përfshihen edhe blerja e shërbimeve ndihmëse, disbalancat negative (OST/KOSTT) dhe devijimet(+) përlogariten në 150.6 GWh.
- Shkëmbimi në marrje i energjisë ka pasur volum prej 228.9 GWh.

Në total, volumi i energjisë elektrike për tregtim nga KESH sh.a. ka rezultuar në sasinë mbi 6.35 TWh ose rreth +0.5 TWh (+8.5%) më shumë se programimi në PEF.

Volumet Hyrëse të energjisë elektrike për vitin 2022, grafikisht paraqiten si më poshtë:

Grafiku 10. Energjia elektrike disponibël për shitje/tregtim për vitin 2022 (MWh)





• **Energji e Shitur (Tregtuar):**

- Energjia e shitur për klientët e FSHU dhe FMF rezulton në sasinë mbi 5.69 TWh ≈ 5.7 TWh. Pra objektivi kryesor për sigurimin e energjisë për DSHP në kushtet e emergjencës është arritur.
- Energjia elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit ka qenë në sasinë prej 90.8 GWh.

- Energjia elektrike e shitur në tregun e lirë (në kushtet e prurjeve) rezulton në sasinë prej gati 195 GWh.
- Kthim Borxhi FTL për mbullim humbje në shpërndarje prej mbi 113 GWh, referuar VKM nr. 456; dt. 29.06.2022.
- Energji e shitur për optimizim portofoli ku përfshihen edhe shitja e shërbimeve ndihmëse, disbalancat pozitive (OST/KOSTT) dhe devijimet(-) përlogariten në rreth 126 GWh ose -16% më pak se programimi i planifikuar prej 150 GWh.
- Shkëmbimi në dhënie i energjisë ka pasur volum prej gati 138 GWh. Si rezultat balanca neto e shkëmbimit është në rreth 91 GWh (pozicion marrje), dhe gati e gjithë sasia është ndaj KEK (88.7 GWh), sasi kjo që do i kthehet shoqërisë KEK gjatë periudhës së tepricave të energjisë elektrike.

Grafikisht, volumet dalëse të energjisë elektrike për vitin 2022, paraqiten si më poshtë:

Grafiku 11. Energjia elektrike e shitur/tregtuar për vitin 2022 (MWh)




5.2 AKTIVITETI NË PLOTËSIMIN E DSHP

Në kushtet e emergjencës së furnizimit me energji elektrike, tregu i energjisë elektrike pësoi rikonfigurim të rëndësishëm me theks tek aktiviteti në tregun e rrgulluar. Në këto kushte prioritet absolut për Korporatën ishte sigurimi dhe furnizimi me energji për plotësimin e detyrimit për shërbim publik.

Për vitin 2022 KESH sh.a ka furnizuar shoqërine FSHU/FTL për klientet universal në sasinë **5,690,689 MWh** sipas detyrimit të vendosur me Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.06.2022, "Për


miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”:

Grafiku 12. Furnizimi – Detyrimi i Shërbimit Publik 2018-2022 (GWh)



Bazuar ne kuotën e DSHP të vendosur nga aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore KESH sh.a. mori masa për të plotësuar kërkesën e plotë të shoqërisë FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve universal. Struktura e burimeve nga u sigurua kjo energji paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 13. Struktura e Sigurimit të Energjisë për DSHP 2022 (GWh)



Për vitin 2022, Korporata e ka plotësuar 61% e kërkesës së klienteve universal nga prodhimi i brendshëm i kaskadës së Drinit, 24% nga importi në tregun e lirë, 11% marrje energji elektrike nga HEC-et e vegjël e me koncension (per atë sasi energji elektrike që tepron mbas mbulimit te humbjeve në rrjetin e

shperndarjes), si dhe 4% shkëmbim/marrje energji elektrike nga shoqëria publike KEK sh.a., në kuadër të marrëveshjes së shkëmbimit me KEK.

Duhet theksuar që aktiviteti në tregun e lirë gjatë vitit 2022, si pasojë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike u kthye në sfidë të vërtetë për Korporatën, si rezultat i plotësimit të DSHP dhe rritjes galopante të çmimit global të energjisë elektrike. Lufta Rusi-Ukrainë dhe vendosmëria e Bashkimit European për të ulur importet e gazit nga Rusia solli një rritje të mëtejshme të çmimeve, ku në muajin Gusht 2022 arriti deri në 1,000 Eur/MWh në profil orar. Shtuar këtyre rrethanave edhe faktorin negativ të kushteve hidro-meteorologjike të vështira të 2022, aktiviteti shitje-blerje në tregun e lirë, u përqendrua në sigurimin e energjisë nga importi dhe minimizimin e efektit negativ me shitje në tregun e lirë (për aq sa ishte e mundur), gjatë 3-mujorit IV me përmirësimin e situatës hidro-meteorologjike. Më poshtë jepet në mënyrë sintetike, ecuria e shit-blerjeve në tregun e parregulluar për periudhën 2014-2022.


Tabela 8. Blerje-Shitjet e energjisë elektrike në Tregun e Parregulluar 2014-2022

Volumi i Transaksioneve (Mln. Euro)	2022	2021	2020	2019	2018	2017	2016	2015	2014
Blerjet e Energjisë në Tregun e Parregulluar (Import dhe Tregu Vendas)	446,1	0,0	0,0	0,0	0,0	23,9	5,2	17,5	9,3
Shitjet e Energjisë në Tregun e Parregulluar (Eksport dhe Tregu Vendas)	33,8	60,17	1,68	7,0	68,4	8,3	41,0	35,4	1,6

*Në tabelen e mësipërme janë vlerat energjise elektrike qe KESH sh.a. ka shitur ne kushtet e prurjeve te medha, perfishire energjine elektrike shitur ne tregun e parregulluar me ane te procedurave te zhvilluara nga DTE.

Veprimtaria në tregun e lirë gjatë 2022, ka rezultuar me efekt negativ neto prej rreth 412.3 Mln. Eur. pasi pavarësisht të ardhurave nga shitja në kushtet e prurjeve të mëdha prej 33.8 Mln. Eur, blerjet për sigurimin e energjisë nga importi kanë kapur vlerën 446.1 Mln. Eur. Grafiki i ky aktivitet për periudhën 2014-2022, paraqitet si më poshtë:


Grafiku 14. Aktiviteti në Tregun e Lirë 2014-2022



Referuar shitjeve në plotësimin e DSHP, për klientët tariforë të OSHEE/FSHU, që përfaqësojnë nivelin e tensionit 0.4 KV me çmim të rregulluar 2.6 Lek/kWh (pa TVSH) dhe klientët tariforë të FMF, që

përfaqësojnë nivelin e tensionit 6/10/20 kV me çmim të rregulluar prej 12 Lek/kWh (pa TVSH), më poshtë pasqyrohen grafikisht pesha e sasive dhe e shitjeve përkatëse në këtë treg të rregulluar:

Grafiku 15. Shitje klientë FSHU vs Klientë FMF (sasi & vlerë)




Pavarësisht se sasia e shitur për Klientët FSHU është 81% vs 19% për klientët FMF, si rezultat i ndryshimit të konsiderueshëm në çmim, shitjet në vlerë për FMF përbëjnë 52% vs 48% për FSHU.

5.3 AKTIVITETE TREGTARE TË TJERA


Në lidhje me Shërbimet e ndihmëse/balancimit për vitin 2022, ato kanë qenë në volume më të ulta, ku aktivizimi në zbritje është -110% më i ulët dhe aktivizimi në rritje -100 më i ulët krahasuar me 2021. Duke qenë se këto shërbime janë pjesë e portofolit të optimizimit, si pasojë e situatës hidrike jo të favorshme, por edhe të sjelljes më korrekte të operatorëve të tjerë, ndaj përgjegjesisë së palëve ndaj mekanizimit për balancim të sistemit ato janë më të ulta krahasuar me 2021. Gjithsesi edhe për vitin 2022 volumet e blerjeve për shërbime balancimi janë përsëri më të larta se ato të shitjeve, duke treguar përsëri rolin vendimtar që ka KESH në ofrimin e këtyre shërbimeve dhe sigurinë që jep sistemit elektroenergjitik të vendit dhe më gjerë edhe atij të Kosovës, duke ofruar këto shërbime edhe për KOSTT. Më poshtë pasqyrohet grafikisht ecuria e shërbimeve të balancimit për periudhën 2018-2022:

Grafiku 16. Shërbimet ndihmëse/balancimit për vitet 2018-2022



Në terma monetarë, të ardhurat neto të krijuara nga ofrimi i shërbimit të balancimit për 2022 janë shumë më të larta, kjo për faktin pasi KESH sh.a. përlogarit çmimin e energjisë balancuese që oferton me çmimin e tregut të energjisë dhe është pjesë e portofolit të optimizimit. Më poshtë pasqyrohet grafiksht dinamika e ecurisë së aktivitetit të netuar të KESH për shërbimet e balancimit me OST dhe KOSTT gjatë periudhës 2018-2022:

Grafiku 17. Të Ardhurat Neto nga shërbimet e Balancimit 2018-2022 (Mln. EUR)




Nga grafiku më lart, qartësisht dallohet përfitueshmëria gjatë 2022 e aktivitetit të shërbimeve të balancimit si rezultat i shit-blerjeve me OST dhe KOSTT, në kushtet e një tregu të lirë dhe me objektiv optimizimin. Pavarësisht se volumet e këtyre shërbimeve janë më të ulta se 2021, të ardhurat janë shumë të larta, si pasojë e çmimeve të larta të kuotimit të energjisë në tregun e lirë për 2022.

Pjesë e liberalizimit të tregut të shërbimeve të balancimit që kanë hyrë në fuqi që prej dt. 01.04.2021, janë edhe shitjet nga kapacitete rezervë, të cilat edhe për pasojë të kuotimit të lartë të çmimeve të energjisë gjatë 2022 kanë arritur vlera të konsiderueshme:

Më poshtë paraqiten të ardhurat nga shitjet për kapacitete rezervë për OST dhe KOSTT 2021-2022:

Grafiku 18. Shitje rezervim kapaciteti 2021 – 2022 (Mln. Eur.)



Të ardhurat për këtë shërbim në 2022 rezultojnë 14.67 Mln. Eur. ose rreth +49%, krahasuar me 2021.

Gjatë vitit 2022 është kryer një menaxhim eficient i portofolit energjetik i orientuar nga sinjalet e çmimeve të tregut, duke përmbushur detyrimin për shërbim publik si dhe duke shfrytëzuar “arbitrage” të çmimeve të ndodhura në tregjet e energjisë elektrike për shit-blerje të energjisë elektrike me qëllim optimizimin e portofolit ekonomik të shoqërisë. Pavarësisht prodhimit të kufizuar si pasojë e situatës hidrike jo të

favorshme dhe prioritetit emergjent për plotësimin e DSHP-së, u arrit që të kryhej aktivitet optimizimi të portofolit energjistik.

Tabela 9. Optimizimi i Portofolit Ekonomik 2018-2022

Transaksionet Komeriale të Optimizimit	2022			2021			2020			2019			2018		
	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)
Blerje energjie elektrike	134.632	26,30	3.541.107	95.455	114,93	10.970.313	78.366	34,89	2.734.658	56.768	46,85	2.659.592	81.509	48,05	3.916.595
Shitje energjie elektrike	91.191	364,60	33.248.585	100.968	159,75	16.129.413	81.089	49,54	4.016.963	42.364	72,20	3.058.611	81.656	65,63	5.358.754
Efekt Financiar për KESH (të ardhura neto nga shitja - blerja)			29.707.479			5.159.100			1.282.305			399.019			1.442.160

Grafiku 19. Efekti i Optimizimit të Portofolit për vitet 2018-2022 (EUR)



KESH e mbylli vitin 2022 me efekt optimizimi neto prej rreth 29.7 Mln. Eur me një diferencë/marzh çmimi mesatar mjaft të kënaqshëm prej 338.3 Eur/MWh. Pothuajse i gjithë optimizimi, vjen nga aktiviteti i shit-blerjes së energjisë me shoqëritë OST e KOSTT për ofrimin e shërbimeve të balancimit.


Në lidhje me shitjet për humbjet në transmetim, VKM nr 456, datë 29.06.2022, ngarkon KESH sh.a. për të mbuluar humbjet e rjetit të transmetimit në periudhën e gjendjes së emergjencës. Në kushtet e mësipërme, shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a. nënshkruan kontratën mes paleve, e cila u miratua nga Bordi i ERE.

Koncretisht per vitin 2022, shoqëria KESH sh.a. për periudhën Korrik-Dhjetor 2022 ka furnizuar shoqërinë OST sh.a. per sasitë e 90,888 MWh energji me një vlerë shitje prej 6.69 Mln. Eur.

Në lidhje me KOSTT gjatë vitit 2022, Korporata nuk ka patur shitje për humbjet në transmetim.

Më poshtë paraqitet grafiksht ecuria në volume dhe vlerë për periudhën 2018-2022:

Grafiku 20. Ecuria për Shitje Humbje Transmetimi (2018-2021)



Referuar grafikut të mësipërm, të ardhurat nga shitjet humbje transmetimi gjatë vitit 2022, ishin -42% më të ulta se viti 2021, kjo edhe për faktin që këto shitje janë kryer vetëm gjatë 6-mujorit II të vitit 2022. Por por çmimi mesatar i shitjes së humbjeve në transmetim gjatë 2022 është 73.6 Eur/MWh, duke treguar efijencë dhe marzh përfitimi/njësi më të lartë se periodha 2018-2021.

6. AKTIVITETI INVESTUES 2022

6.1 REALIZIMI I INVESTIMEVE PËR VITIN 2022

Në lidhje me investimet gjatë vitit 2022, Korporata është treguar mjaft e kujdesshme në menaxhimin e fondeve. Kjo për arsye e gjendjes së emergjencës në sektor. Në zbatim të kushteve ligjore dhe politikave për menaxhimin me efijencë të kostove në tërësi dhe në veçanti të investimeve, janë kryer ato më të domosdoshmet për të siguruar një aktivitet normal të shoqërisë. Kryesisht, investimet janë përqendruar në investime rinovuese kapitale të nevojshme për aktivitetin e operim/shfrytëzimit dhe në infrastrukturën kritike të teknologjisë dhe informacionit.

Në total realizimi i investimeve gjatë 2022 ka kapur vlerën e mbi 2.752 Mld. Lek. Krahasuar me Planin Ekonomik prej gati 5.108 Mld. Lek, investimet janë realizuar në masën 54%. Ky është një tregues optimal, po të kermi në konsideratë kushtet e aktivitetit në situatën e emergjencës i cili krijon presion të lartë ndaj Cash-flow dalës, sidomos për blerjen e energjisë me çmuime të shtrenjta nga importi duke i shtuar kësaj edhe situatën jo të favorshme hidrike, e cila kufizon Cash-Flow hyrë nga të ardhurat, aq të nevojshmem për të çuar përpara investimet e shoqërisë.

Politika investuese e Korporatës është fokusuar në sigurinë dhe efçencën e veprave hidrike, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të investimeve pasi asetet gjeneruese aktuale, për vetë madhësinë dhe problematikat e amortizimit të tyre në vite, kanë nevojë për investime mirëmbajtëse/rinovuese dhe modernizuese periodike.

Ndërkohë, fokusi është shtuar edhe tek zhvillimi i qëndrueshëm strategjik nëpërmjet investimeve në kapacitete të reja dhe të diversifikuara të BRE, me projekte konkrete për zbatim në këtë fushë.


Refeuar tabelës së mëposhtme, si pasojë e situatës së emergjencës në sektorin elektroatërgjetik dhe vitit të pafavorshëm hidrik, në vitin 2022 vërehet një ulje e realizimit të investimeve prej -38%, krahasuar me realizimin në 2021.

Tabela 10. Realizimi i Investimeve për vitet 2016-2022

VLERA E INVESTIMEVE TË REALIZUARA	2022	2021	2020	2019	2018	2017	2016
Investimet e vetë financuara (mln. lekë)	2.325	3.347	2.262	384	1.459	3.256	2.544
Investimet me financim të huaj (mln. lekë)	427	1.072	1.146	883	917	1.223	937
TOTAL	2.752	4.419	3.408	1.267	2.376	4.478	3.481
Fierzë	142	785	822	122	662	1.603	478
Investimet sipas Njësive (mln lekë)							
Koman	288	990	1.813	895	1.206	1.590	1.860
Vau Dejës	531	828	422	107	355	1.165	483
Aparati Qëndror	1.791	1.816	351	143	153	120	659

Shpërndarja e Investimeve të realizuara për 2022, sipas njësive/qendrave të kostos, ndahet në masën përkatësisht në HEC Fierzë 149 Mln.Lek (5% e totalit); HEC Koman 288 Mln. Lek (11% e totalit); HEC Vau i Dejës 531 Mln. Lek ose 19% dhe KESH Qëndër + TEC Vlora 1,791 Mln. Lek (65% e totalit).

Grafiku 21. Realizmi i Investimeve sipas Burimit të Financimit 2016-2022



Referuar grafikut të mësipërm, burimi i financimit të investimeve realizuara për 2022 ndahet në 84% i financimit me fondet e vetë Korporatës dhe 16% me financim të huaj. Edhe grafikisht vërehet që për 2022, krahasuar me vitet e mëparshme, pjesa e financimit me fonde të huaja është zvogëluar. Kjo për arsye se Projekti i Sigurisë së Veprave Hidrike është drejt finalizimit. Gjithsesi me fillimin e projektit të Rehabilitimit Elektro-Mekanik të HEC Fierzë, ky lloj financimi do të rritet ndjeshëm.


Në lidhje me qëllimin e realizimit të investimeve, ato ndahen në 3 drejtime kryesore si më poshtë:

- Garantimi i sigurisë së veprave;

- Rritja e efijencës në prodhim, ku përfshihen edhe investimet në shtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese;
- Përmirësimi i kushteve të punës.

Më poshtë paraqitet grafiksht, ndarja e investimeve të realizuara gjatë 2022 sipas këtyre kategorive:

Grafiku 22. Realizimi i Investimeve për vitet 2016-2021



Nga grafiku i mësipëm vërehet se ndryshe nga vitet e tjera ku volumi më i madh i fondit të investimeve është alokuar për rritjen/garantimin e sigurisë së veprave, gjatë 2022 realizimi më i madh ka kaluar tek rritja e efijencës së prodhimit/kapacitetet e reja me 76.4% kundrejt 23.5% për rritjen/garantimin e sigurisë së veprave. Kjo për 2 arsye kryesore:

1. Ashtu si theksuam edhe më lart, duke qenë se garantimi i sigurisë së veprave është i lidhur më së shumti me Projektin e Sigurisë së Veprave Hidrike, i cili është drejt finalizimit, prandaj edhe për vitin 2022 kjo kategori investimesh ka pasur një peshë më të vogël;
2. Objektiv i Rritjes së Efijencës/kapacitetet e reja ka zënë peshë më të madhe gjatë 2022, pasi pjesa më e madhe e investimeve janë të tipit investues-rinovues, investime në fushën e teknologjisë dhe informacionit dhe me rritjen e kapaciteteve të reja, veçanërisht lidhur me gjeneruesit termik lundrues dhe Fazën e I të projektit të HEC Skavica.

6.2 INVESTIMET E FINANCUARA NGA PARTNERËT NDËRKOMBËTAR

Investimet në Sigurinë e Digave financohen paralelisht nga disa institucione ndërkombëtare financiare si Banka Botërore (WB), Sekretariati Shtetëror i Bashkëpunimit Financiar Zviceran (SECO), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Banka Botërore ka rolin e udhëheqësit ndër këto institucione të cituara më lart.

1. Banka Botërore (WB) – SDR 21.7 Milion

- *Rehabilitimi i Portave të Shkarkimit të HEC-eve Fierzë dhe Koman*

Rehabilitimi i portave të mirëmbajtjes dhe shkarkimit ne HEC Koman dhe Fierze përfundoi me sukses duke realizuar objektivin 100% në muajin Nëntor 2021.

Disbursimet e pagesave janë realizuar sipas procedurave të Bankës Botërore deri në muajin Prill 2022.

2. SECO – CHF 6.4 Milion

- *Projekti i Sigurisë së Digave në Kaskadat e lumenjve Drin*

I nënshkruar më 24 Maj 2011, projekti fillestar u përfundua me sukses me investimet në:

- Furnizimin dhe Instalimin i Sistemeve të Monitorimit Gjeologjik dhe Sizmik të Digave të Kaskadave Drin.
- Furnizimin dhe Instalimin i Sistemeve të Monitorimit Gjeodetik të Digave të Kaskadave Mat dhe Drin.
- Mbrojtja nga Rreziku i rënies së shkëmbinjve në HEC Fierzë.

Marrëveshja e Projektit pas amendimeve të kryera është e vlefshme deri në fund të vitit 2022. Aktualisht SECO po suporton Departamentin e Sigurisë së Digave me ekspertizë në argumentimin e të dhënave monitoruese të digave në kaskadën e Drinit.

3. BERZH (EBRD) – EUR 12.7 Milion

- *Rehabilitimi i portave të shkarkimit të HEC Koman*

Marrëveshja e Financimit me BERZH në shumën e EUR 12.7 milion është bërë efektive më 15 Nëntor 2013. Kjo marrëveshje financoi rehabilitimin e Digës së Komanit e cila përfundoi me sukses në Korrik 2016. Financimi prej EUR 6.128 milion i kursyer nga kjo marrëveshje u transferua si bashkëfinancim me Bankën Botërore për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC Koman dhe Fierzë. Ky transferim është ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligj të posaçëm. Afati i fundit të disbursimeve për këtë marrëveshje është deri në 31 Dhjetor 2021.

Kontrata ka përfunduar me sukses duke disbursuar shumën e financimit 100%.

4. KfW – EUR 20 Milion

- *Rehabilitimi i Portave të Shkarkimit të HEC Vau i Dejës*

Konsulent i zbatimit të projektit është Fichtner GmbH Gjermani i cili po asiston në kontraktimin për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC Vau i Dejës dhe mbikqyrjen e zbatimit të projektit. Kontrata është në proces deri në fund të vitit 2023. Gjatë 2022, investimet janë përqendruar më së shumti në rehabilitimin e portave të mirëmbajtjes dhe shkarkimit në HEC Vau i Dejës. Punimet sipas marrëveshjes, pritet të përfundojnë në muajin Tetor 2023. Gjatë vitit 2022 kanë përfunduar portat e mirëmbajtjes dhe shkarkimit në digën e Zadejës dhe puna po vazhdon në rehabilitimin e portave të digës së Qyrsaqit.

- *Implementimi i Qendrës së Kontroll-Monitorimit të Kaskadës së lumit Drin.*

Konsulenti i zbatimit të këtij aktiviteti është duke realizuar procedurat kontraktuale dhe nuk paraqet asnjë problematikë. Kontrata është duke u zbatuar sipas parashikimeve kontraktuale.

Kontraktori i zbatimit të projektit është duke zbatuar kontratën pa problematika dhe pritshmëria e realizimit të tij parashikohet deri në fund të 2023.

4.1. KfW – EUR 40 Milion Kredi + EUR 2 Milion Grant

- *Projekti për rehabilitimin Elektro-Mekanik të HEC Fierzë*

Në bazë të ligjit Nr. 69/2021 datë 20.5.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Rehabilitimi i HEC Fierzë”.

Marrëveshja e huasë në shumën 40 Mln. EUR ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Korporatës Elektroenergetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main për rehabilitimin Elektro-Mekanik të HEC Fierzë ratifikuar me ligjin nr 44/2022 datë 28.04.2022 ka hyrë në fuqi më datë 28.05.2022 dhe është bërë efektive më datë 23.08.2022.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje u sigurua një kredi e butë nga Banka Gjermane e Zhvillimit KfW e cila do të shkojë për rehabilitimin e plotë elektro-mekanik të HEC Fierzës. Përveç kredisë nga Banka Gjermane e Zhvillimit KfW, nëpërmjet programit WBIF u akordua edhe një grant prej 8.35 Mln. EUR nga BE për këtë projekt.

Marrëveshja e Grantit shoqëruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë, KfW Frankfurt am Main dhe KESH sh.a. për shumën 2 Mln. EUR, për masat shoqëruar rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës.

Në Total projekti kap vlerën e financimit *50.35 Mln. EUR = 40 Mln. EUR Kredi + 10.35 Mln. EUR Grant.*

Kontrata me konsulentin e zbatimit tashmë është realizuar dhe projekti është në fazën e hartimit të specifikimeve teknike dhe dosjes së tenderit për punimet rehabilituese. Pritshmëria për fillimin e punimeve rehabilituese përkon me muajin Tetor 2023. Aktualisht nuk paraqitet asnjë problematikë.

Ky projekt madhor ka rëndësi shumë të madhe si për mirëmbajtjen ashtu si dhe për sigurinë dhe cilësinë e prodhimit, pasi lidhet me rehabilitimin Elektro-Mekanik të hidrocentralit të sipërm të kaskadës dhe rregullator të gjithë kaskadës së Drinit, me një impakt thelbësor në menaxhimin operacional të prodhimit.

6.3 INVESTIMET ME FONDET E VETA

1. Si pasojë e gjendjes së emergjencës në sektor, viti 2022 pati kufizim në realizimin e investimeve. Pavarësisht këtyre vështirësive investimet në monitorimin e veprave hidroteknike dhe disa në rritjen e sigurisë tyre u arritën të realizohen. Gjatë vitit 2022, ndër investimet më kryesore të Korporatës në funksion të sigurisë së veprave hidroteknike të përfunduara ose në proces përmendim në vijim:

- Mbrojtja e shpatit të djathtë të digës HEC Koman;
- Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës lidhëse të galerisë së kuotës 178 mmnd në Fierzë;
- Rehabilitimi i tuneleve dhe galerive ndihmëse të digës Koman;
- Mbrojtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së koluvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman;
- Rikonstruksioni i sallës së makinerive, sallës së turbinave dhe galerive në godinën e centralit të HEC-it (Koman);
- Mbilartësimi, ndërtim/instalim i pritave malore tek përrenjtë e Salcës dhe Bugjonit (në proces);

Investimet të cilat nuk mundën të implementohen gjatë vitit 2022, janë planifikuar të fillojnë implementimin gjatë vitit 2023. Kjo është e parashikuar në Programin Ekonomik të vitit 2023.

2. Me fondet e vetë Korporatës janë kryer ose janë në vazhdimësi investime të profilit elektro-mekanike të karakterit riparues/rinovues si:

- Projekti “Rehabilitimi me Rinovim Teknologjik të Kushinetave Mbështetëse të 5 agregateve të HEC Vau Dejës”. Me rehabilitimin e AG.1 dhe AG.3 gjatë vitit 2022, kjo kontratë ka përfunduar me sukses për të vazhduar me periudhën garancisë.
- “Rehabilitimi elektro-mekanik i vinçit 2 x 10 ton në bjeftin e poshtëm në HEC Fierzë”;
- “Rinovimi i sistemit të mbrojtjeve për 2 Agregatë me vendosje/konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”;
- Projekti “Ndërhyrje për Mirëmbajtjen e Sistemeve të CO2 në HEC Fierzë dhe HEC Koman”.

Investimet të cilat nuk mundën të implementohen gjatë vitit 2022, janë planifikuar të fillojnë implementimin gjatë vitit 2023. Kjo është e parashikuar në Programin Ekonomik të vitit 2023.

3. Në fushën e Automatizimit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për shkak të situatës kibernetike në rajon janë ndërmarë një sërë masash të kombinuara edhe me investime për të akomoduar këto çështje në kuadër të rritjes së përshtatshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Masat organizative përmbledhen në:

- Masat e menaxhimit të sigurisë së informacionit;
- Masat e menaxhimit të rrezikut;
- Masat e politikave të sigurisë;
- Masat sigurisë organizative;
- Masat e kërkesave të sigurisë për palët e treta;
- Masat e menaxhimit të aseteve;
- Masat e sigurisë së burimeve njerëzore dhe aksesit të personave;
- Masat ndaj ngjarjeve të sigurisë dhe menaxhimit të incidenteve të sigurisë kibernetike;
- Masat e menaxhimit të vazhdimësisë së punës (Business Continuity Management);

- Masat e kontrollit dhe auditit.

Masat administrative/organizative janë shoqëruar me masat teknike si më poshtë:

- Masat e sigurisë fizike;
- Masat e mbrojtjes së integritetit të rrjeteve të komunikimit;
- Masat e menaxhimit për autorizimin e aksesit;
- Masat e veprimtarisë së administratorëve dhe të përdoruesve;
- Masat e mjeteve të gjurmimit dhe vlerësimit të ngjarjeve të sigurisë kibernetike;
- Masat e sigurisë së aplikacioneve;
- Masat e sigurisë së pajisjeve kriptografike;
- Masat e sigurisë së sistemeve industriale.

Investime kryesore në fushën e automatizimit, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit mund të përmendim:

- Monitorimi gjeodezik i Digave të kaskades së lumit Drin dhe masiveve të paqëndrueshëm gjeodezik pranë tyre;
- Upgrade i versionit të software të sistemit SCALA 250, sistemit operativ dhe hardware për DCS SCADA në HEC Koman;
- Sistemi i sigurisë kibernetike Faza 2;
- Vazhdimi i implementimit të sistemit ERP të Menaxhimit (moduli i menaxhimit të kontratave);
- Program për menaxhimin e projekteve të shit-blerjes së energjisë;
- Sistemi i parashikimit satelitor të METEO Faza 2;
- Studimi i menaxhimit të emergjencave dhe kontrollit të sigurisë së digave Faza 1;
- Sistemi i monitorimit të infrastruktures IT dhe menaxhimi i shërbimeve të helpdesk;
- Sistemi i DMS dhe arkivës teknike;
- Blerje Licenca dhe Software për sistemet informatike;
- Konsulencë për implementimin e standartit ISO 27001 në sistemet TIK të KESH sh.a.

Objektivat për vitin 2023 është përafrimi i standarteve dhe certifikimi drejt ISO 27001 duke ndihmuar DATIK dhe KESH të ketë procedura, rregullore të qarta dhe funksionale për të siguruar të gjithë aktivitetin teknologjik, duke evidentuar çdo rrezikshmëri kibernetike si faktor kyç për infrastrukturën kritike, si dhe ngritja e qendrës së monitorimit dhe kontrollit të HEC-eve.

6.4 ECURIA E PROJEKTEVE BRE DHE PËRGJEGJSHMËRIA SOCIAL-MJEDISORE

Si objektivi i rëndësishëm i zhvillimit strategjik dhe të qëndrueshëm i Korporatës është edhe rritja e kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet burimeve të diversifikuara. Kjo strategji e ndjekur nga Korporata është në linjë me politikat kombëtare të vendosura nga Qeveria Shqiptare, dhe bazuar në dokumentin “Zhvillimi i Strategjik i Sektorit Energjetik”, përgatitur nga CMA dhe Growth Lab të Universitetit të Harvardit. Ky dokument përfaqëson një udhërrëfyes, i cili shpalos rrugët konkrete për një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë dhe të integruar të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar, ku KESH sh.a. si një aktor qendror i sektorit ka rol kryesor. Pavarësisht vështirësive si rezultat i gjendjes së emergjencës, gjatë vitit 2022, është për tu evidentuar avancimi i projekteve të Korporatës për shtimin dhe diversifikimin e kapaciteteve të reja të burimeve të rinovueshme të energjisë.

- Impianti fotovoltaiq 5.14 MWp në digën e Qyrsaqit të HEC Vau i Dejës:

Fillimi i aktivitetit gjenerues i impiantit PV me fuqi të instaluar prej 5.143 MW, i instaluar në digën e Qyrsaqit-HEC Vau i Dejës, si i pari burim i diversifikuar që i shtohet portofolit gjenerues të Shoqërisë. Ndërtimi i impiantit fotovoltaiq u financua me fondet e vet Korporatës. Kjo është një arritje për Shoqërinë dhe në funksion të objektivit afatgjatë zhvillimor të rritjes së kapaciteteve gjeneruese, nëpërmjet diversifikimit. Impianti filloi zyrtarisht prodhimin më 12 Maj 2022. Gjatë vitit 2022 ky impiant prodhoi 4,203 MWh energji elektrike.

- Projekti për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës:

Viti 2022, përkoi me realizimin e Fazës I të projektit të HEC Skavica, e cila përfshin kryesisht të gjithë punën përgatitore për sa i përket të gjitha studimeve që do të bëhen, duke nisur nga studimi mjedisor, gjeologjik, teknik dhe social. Kjo fazë ka hyrë në fuqi në datë 24.08.2021. Aktualisht pas disa diskutimeve, priten të paraqiten variantet përfundimtare të studimeve të realizuara të cilat do të kalojnë procesin e vlerësimit nga strukturat e KESH sh.a. dhe më pas është parashikuar oponenta në bashkëpunim me stafin e pedagogëve të UPT.

Sipas parashikimit aktual, pritet që deri në Qershor 2023 të përfundojnë aktivitetet kryesore të Fazës I dhe më pas të fillojnë përgatitjet për Fazën II të kontratës.

- Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltaiq lundruar 12.9 MWp në liqenin e Vaut të Dejës:

Zhvillimi i këtij projekti po realizohet në bashkëpunim të ngushtë me BERZH, e cila ka shprehur gatishmërinë për financimin e këtij projekti nëpërmjet një kredie tregtare. Gjatë këtij viti u nënshkrua marrëveshja e kredisë ndërmjet KESH sh.a. dhe BERZH, si dhe gjithashtu ka përfunduar procesi për përzgjedhjen e supervizorit. Aktualisht ka përfunduar procesi i tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit dhe është në fazë vlerësimi i aplikimeve. Po kështu projekti ka fituar një mbështetje financiare grant në kuadër të programit financiar të WBIF-EIP. Gjatë këtij viti pritet të nënshkruhet marrëveshja me kontraktorin dhe fillimi i punës për projektin e detajuar teknik dhe fillimin e punimeve..

- Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltaiq 8.25 MWp në digën e Zadejës të HEC Vau i Dejës:

Ky është një projekt i cili ka marrë miratimin paraprak në MIE. Aktualisht janë duke u përgatitur termat e referencës për përzgjedhjen e kontraktorit i cili do të realizojë studimet e nevojshme për fazën e miratimit për ndërtim dhe më pas ndërtimin e impiantit. Deri në fund të këtij viti synohet të përfundojnë gjithë studimet e fazës së miratimit për ndërtimin dhe marrja e të gjithë lejeve të nevojshme. Objektivat dhe rëndësia e këtij projekti janë të njëjta me projektin e impiantit fotovoltaiq në digën e Qyrasqit.

- Projekti për impiantin fotovoltaiq 50 MWp në zonën Belsh:

Ky është një projekt në shkallë të gjerë dhe me impakt që synon diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike. Aktualisht projekti është në fazë fillestare ku ka përfunduar procesi i parafizibilitetit. Për zhvillimin e këtij projekti ka shfaqur interes për ta financuar BERZH, nëpërmjet një kredie me terma preferencial si dhe nëpërmjet një granti për asistencë teknike për realizimin e studimeve dhe projektit teknik. Gjithashtu projekti ka kërkuar mbështetje në programin e WBIF për një grant për investimin.

- Situata e TEC Vlorë:

Edhe gjatë vitit 2022, shoqëria TEC Vlora sh.a., ka kryer aktivitetin e saj në lidhje me konservimin e asetit gjenerues i cili nuk është në gjendje pune për shkak të problematikave të shfaqura që nga viti 2012. Gjatë vitit 2021 MIE ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Korporatën ndërkombëtare amerikane Exxelerate (Exxon Mobile), e cila ka marrë përsipër vlerësimin tekniko-ekonomik për rivënie në punë të TPP Vlora. KESH sh.a. dhe MIE janë në pritje të një konkluzioneve të studimit për rivënie në punë të këtij impianti, duke konsideruar edhe alternativën furnizimin me lëndë djegëse të impiantit të llojit Gaz apo LNG.

- Përgjegjshmëria Social-Mjedisore

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe si prodhues i energjisë elektrike 100% në formën hidro (nëpërmjet HEC), një rëndësi të veçantë për Korporatën në vitin 2022 ka patur organizimi i aktiviteteve studimore (kryesisht në HEC Vau Dejës) sipas programit të edukimit dhe informimit me brezin e ri. Qëllimi këtyre aktiviteteve me shkollë të ndryshme në Tiranë ka qenë informimi në lidhje me prodhimin e energjisë së rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, shfrytëzimin racional të qëndrueshëm të burimeve ekzistuese si dhe synimet për të nxitur përdorimin e burimeve të reja të rinovueshme të energjisë. Veçanërisht në situatën e emergjencës gjatë vitit 2022, u zhvillua fushata sensibilizuese për kursimin e energjisë elektrike nga popullata, e cila pati efekte mjaft pozitive. Gjithashtu, në kuadër të forcimit të

bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare të profilizuara në zhvillimin e qëndrueshëm harmonik si anëtar i IHA (International Hydropower Association), janë realizuar disa programe trajnimi për stafin e KESH në kuadër të “Capacity Building” gjatë vitit 2022. IHA ka luajtur një rol udhëheqës në zhvillimin e Standardit dhe Mjeteve të Qëndrueshmërisë së Hidroenergjisë. Standardi përdoret për certifikimin e performancës së qëndrueshmërisë së projekteve hidroenergetike në mbarë botën. Gjatë vitit 2022 KESH sh.a me asistencën e IHA po nis procesin për standardizimin Skavicës që në fillimet e tij si Aset i Qëndrueshëm i Hidroenergjisë.

7. AKTIVITETI EKONOMIKO-OPERACIONAL PËR VITIN 2022

Ashtu si u evidentua edhe më lart, viti 2022, rezultoi mjaft sfidues në aktivitetin operacional, si rezultat i situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, prej çmimeve të larta të importit, duke i mbivendosur edhe situatën jo të favorshme hidro-meteorologjike të kësaj periudhe. Këta faktorë ndikuan negativisht dhe ekspozuan ndjeshëm Korporatën ndaj riskut të tregut (çmimet e larta të importit) nga njëra anë, dhe nga ana tjetër nga risku hidro-meteorologjik (volumet e kufizuara të prodhimit të brendshëm). Përballë kësaj situatë, prioriteti dhe detyra kryesore ishte plotësimi i DSHP-së me çdo mundësi, në mënyrë që konsumatorit vendas, mos ti mungonte energjia dhe të mos ti rritej kostoja e energjisë. Në rrafshin ekonomik-operacional, kjo barrë financiare do të binte mbi shtetin dhe posaçërisht mbi Korporatën.

Më poshtë jepen indikatorët kryesorë të aktivitetit ekonomik për vitin 2022 dhe krahasimi i tyre me mesataren 5 vjeçare 2017-2021.

Duhet theksuar që të dhënat ekonomik-financiare të paraqitura në këtë kapitull janë të stadiit operacional dhe për rrjedhojë të paçertifikuara ende nga audituesit.

Tabela 11. Treguesit kryesorë të veprimtarisë ekonomike 2017-2022

Treguesit e Aktivitetit Ekonomik	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Mesatarja 5-vjeçare (2017-2021)
Energjia Neto e Prodhuar nga KESH sh.a (GWh)	3.860	5.346	3.090	2.979	5.851	2.915	4.036
Të Ardhura ('000 Lekë) ¹	36.609.329	18.904.679	11.366.643	9.910.229	18.396.176	7.289.888	13.173.523
Fitimi / (Humbja) neto për periudhën ('000 Lekë)	-25.819.102	6.003.405	2.087.198	1.863.170	10.391.871	-52.727	4.058.583
Llogari të Pagueshme ('000 Lekë)	25.332.173	10.755.158	41.852.854	48.136.620	39.782.769	55.988.262	39.303.133
Llogari të Arkëtueshme ('000 Lekë)	72.685.314	63.172.079	62.113.518	57.662.140	64.527.159	57.556.133	61.006.206
Shpenzimet Fikse Operacionale ('000 Lekë) ²	2.295.441	2.217.636	2.049.910	1.819.613	1.790.946	1.995.347	1.974.691
Shpenzime Operative (Lekë/GWh)	595	414,84	663,36	610,76	306,10	684,49	535,91

1) Të ardhurat përbejnë shitjet për klientët tariforë të OSHEE, shitje në tregun e parregulluar dhe optimizim. Tek Shërbimet ndihmëse dhe të balancimit. Tek rubrika të ardhura të tjera përfshihen të ardhura ekstra bazuar në kontrata mbi energjinë elektrike (si kamatvonesa, penalitete etj.).

2) Shpenzimet operative fikse lidhen vetëm me aktivitetin operacional të shoqërisë duke zbritur zhvlerësim/amortizimin dhe blerjet e energjisë.

Referuar të dhënave në tabelën e mësipërme, treguesit kryesorë vlerësohen shkurtimisht si më poshtë:

- Të ardhurat prej aktivitetit kryesor 36.6 Mld. Lek konsistojnë në: rreth 30 Mld. Lek nga shitja e energjisë në tregun e rregulluar për përmbushjen e DSHP, tregun e parregulluar, optimizim, shitje humbje transmetimi dhe disbalanca. Shërbimet ndihmëse energjetike janë 5.26 Mld. Lek, dhe “Të ardhurat të tjera” ku përfshihen të ardhura ekstra bazuar në kontrata mbi energjinë elektrike (si kamatvonesa, penalitete etj.) kryesisht ndaj OSHEE dhe OST në vlerën prej 1.4 Mld. Lek;
- Rezultati neto për periudhën është në vlerën rreth -25.82 Mld. Lek, ndikuar totalisht nga shpenzimet e importit të energjisë të cilat arritën në 52.52 Mld. Lek, duke dhënë impaktin negativ në rezultatin ekonomik të periudhës;

- Vlen të theksohet se indikator i “Shpenzimet Operative Fikse/GWh të prodhuar” është në vlerën 595 Mijë Lek/GWh të prodhuar, duke ulur këtë tregues me vite të ngjashme prodhimi si 2020, 2019 dhe 2017, duke treguar rritje të efijencës operacionale të Korporatës;
- Si tregues i vlerësimit të likuiditetit, vërehet se “Llogaritë e Arkëtueshme” në fund të 2022 janë rritur me rreth 9.5 Mld. Lekë (+15%), krahasuar me 2021, duke ndikuar negativisht në likuiditetin e Korporatës dhe çenuar ndjeshëm zhvillimin ekonomik-financiar, sidomos aktivitetin investues të saj;
- Si tregues i vlerësimit të aftësisë paguese (solvency), vërehet se “Llogaritë e Pagueshme” në fund të 2021 janë rritur me 14.6 Mld. Lekë (ose +136%), krahasuar me 2021. Rritja e këtij zëri, tregon uljen e aftësisë paguese si pasojë e efektit të lidhjes që krijohet ndërmjet “Llogarive të Arkëtueshme” dhe “Llogarive të Pagueshme”, aktorët e tjerë të sektorit nuk paguajnë ose paguajnë pjesërisht detyrimet ndaj KESH, duke mbajtur të larta “Llogaritë e Arkëtueshme” dhe kushtëzuar flukset hyrëse të likuiditetit aq të nevojshëm për soliditetin ekonomik-financiar.


Tabela 12. Pasqyra Operacionale e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve 2022

(Shumat janë të shprehura në mijë lekë)	PL_PEF 2022 (i miratuar)	PL 2022 Realizimi (operacional)	Ndryshimi në vlerë (Realizim 2022 vs Plan 2022)	Ndryshimi në % (Realizim 2022 vs Plan 2022)
Operacionet e vijueshëm				
- Të ardhura nga shitja e energjisë:	28.679.292	35.205.750	6.526.458	22,76%
Shitjet e Energjise për klientët tariforë të OSHEE/FSHU	12.040.154	10.818.307	-1.221.847	-10,15%
Shitjet e Energjise për klientët tariforë të FMF	12.862.968	10.527.948	-2.335.020	-18,15%
Te ardhura nga faturim shtese FSHU	0	3.473.827	3.473.827	100,00%
Shitjet e Energjise për mbulimin e humbjeve të OSHEE	0	0	0	0,00%
Shitjet e Energjise për humbjet e Transmetimit OST	0	778.474	778.474	100,00%
Shitje energjie elektrike për humbjet e Transmetimit KOSTT	0	0	0	0,00%
Shitjet e Energjise me çmime tregu dhe optimizim (eksport dhe tregu vendas)	811.462	4.251.291	3.439.829	423,90%
Shitje Energjie për mbulimin e Disbalancave	43.949	94.969	51.020	116,09%
Të Ardhura Shërbime ndihmëse për OST	1.646.121	4.097.482	2.451.360	148,92%
Të Ardhura Shërbime ndihmëse për KOSTT	1.270.242	1.159.185	-111.057	-8,74%
Të Ardhura te tjera energjie elektrike (Ashta+Naa)	4.395	4.267	-128	-2,91%
- Të ardhura të tjera operacionale	10.500	1.403.579	1.393.079	13267,42%
Shuma e të Ardhurave Operative	28.689.792	36.609.329	7.919.537	27,60%
- Materiale të para dhe të konsumueshme	201.522	102.214	-99.308	-49,28%
- Blerje Energjie:	21.433.117	57.779.945	36.346.827	169,58%
Blerje Energjie Elektrike me çmime tregu (import dhe tregu vendas)	20.156.545	52.522.408	32.365.863	160,57%
Blerje Energjie Elektrike për optimizim (import dhe tregu vendas)	994.952	240.437	-754.515	-75,83%
Kompesimi financiar për FITL për energjinë e pakthyer nga depozitimi	0	4.619.689	4.619.689	100,00%
Tarifë Transmetimi	6.758	5.734	-1.023	-15,15%
Blerje Energjie për mbulimin e Disbalancave	155.652	243.782	88.130	56,62%
Blerje Shërbime ndihmëse OST	119.211	147.895	28.684	24,06%
Blerje Shërbime ndihmëse KOSTT	0	0	0	0,00%
Shpenzime te tjera energjie elektrike	0	0	0	0,00%
Shpenzime personeli	1.382.201	1.241.443	-140.758	-10,18%
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	3.610.810	3.841.114	230.304	6,38%
Shpenzime të tjera operacionale	1.152.115	977.056	-175.059	-15,19%
Shuma e Shpenzimeve Operative	27.779.765	63.941.772	36.162.006	130,17%
EBIT	910.026	-27.332.442	-28.242.469	-3103,48%
Të ardhura financiare	124.508	2.597.279	2.472.771	1986,03%
Shpenzime financiare	-678.048	-1.082.937	404.889	59,71%
Të Ardhura/Shpenzime Financiare Neto	-553.540	1.514.342	2.067.882	373,57%
Rezultati para tatimit	356.486	-25.818.100	-26.174.587	-7342,38%
Kreditim i tatimit mbi fitimin				
Shpenzime tatim fitimi	-53.473	0	-53.473	-100,00%
Fitimi Neto i Periudhës nga operacionet e vijueshëm	303.013	-25.818.100	-26.121.114	-8620,45%

- Të ardhurat totale janë rritur me 27.6% krahasuar me PEF. Kjo rritje përbëhet nga të ardhurat nga aktiviteti korrent i shitjes së energjisë me 22.76 % dhe "Të ardhura të tjera operationale" që janë kryesisht nga penalitete për vonesa në pagesën e faturave nga OST & FSHU me 4.84%.
- Shpenzimet totale të periudhës rezultojnë 63.94 Mld. Lek me një rritje prej 36.16 Mld. Lek ose +130%, krahasuar me PEF. I gjithë efekti i rritjes së shpenzimeve vjen nga "Blerja e Energjisë në tregun e Parregulluar/Importi", për të përballuar furnizimin për DSHP. Ky zë shpenzimi, i cili përbën 90% të gjithë totalit të shpenzimeve, u rrit ndjeshëm me +32.37 Mld. Lek ose +161%, krahasuar me parashikimin, pasi Korporata u ekspozua ndjeshëm nga kushtet jo të favorshme hidro-meteorologjike, të cilat kufizuan prodhimin e brendshëm duke e detyruar të blejë sasi energjie të konsiderueshme.
- Veçojmë faktin që shpenzimet tjera operationale si "Shpenzime Personeli" (-10%), "Materiale të Para dhe të Konsumueshme" (-49.3%) apo "Shpenzime të tjera Operationale" (-15%), janë më të ulta se PEF, duke treguar një qasje mjaft efikente në menaxhimin e kostove fikse operative-administrative.
- Aktiviteti operacional financiar rezultoi pozitiv me një rritje neto prej +2 Mld. Lek ose +3.7 herë më të larta se parashikimi, kryesisht nga "te ardhura nga interesat" dhe "fitim nga kursi i kembimit".
- Si pasojë e rritjes së ndjeshme të shpenzimeve operative me +130.2%, krahasuar me rritjen e të ardhurave operative me vetëm +27.6%, aktiviteti ekonomik-operacional për vitin 2022 rezultoi me 25.82 Mld. Lek humbje neto nga operationet e vijueshëm (rezultati përfundimtar duhet çertifikuar).

Realizimi operacional i aktivitetit për 2022, praqitet grafikisht si më poshtë:

Grafiku 23. Pasqyra Operacionale të Ardhura/Shpenzime 2022 ('000 Lek)



Edhe grafikisht shikohet qartë shpenzimi gjatë 2022 për “Blerje energjie me çmime tregu”, për të siguruar energjinë për furnizimin në kuadër të plotësimit DSHP-së, e cila është absorbuar nga Korporata dhe sigurisht nga Buxheti i Shtetit. Kjo me objektivin madhor, të sigurimit të energjisë elektrike në këtë situatë të vështirë tregu dhe hidro-meteorologjike dhe pa ndryshuar çmimin ndaj konsumatorit final, duke e mbrojtur atë nga rritja e çmimit të këtij produkti jetik i cili ndikon drejtpërdrejt në koston e jetesës.

8. KONKLUZIONE

Referuar performancës së aktivitetit në 2022, zhvillimeve/ngjarjeve në sektorin Elektroenergjetik dhe nën optikën e parashikimeve për 2023, konkluzionet kryesore janë:

- Viti 2022 përshkruhet si një vit specifik dhe i vështirë, ku aktiviteti operacional i Korporatës u përball me sfida të vështira për shkak të rritjes globale të çmimeve të energjisë dhe gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji. Ky vit ishte një vit i sfidave të mëdha për të gjithë sektorin elektroenergjetik dhe veçanërisht për KESH sh.a.. Korporata ka detyrimin që gjatë gjendjes së emergjencës të sigurojë të gjithë energjinë elektrike e nevojshme për FSHU sh.a. për përmbushjen e detyrimit ndaj klientëve FSHU, klientëve tariforë FMF si dhe sasia e tepërt për OSSH për mbulimin e humbjeve në shpërndarje. Në kushtet e emergjencës, kjo përgjegjësi dhe arritja e këtij objekti madhor paraqiti një sfidë të vërtetë. Megjithatë edhe në këto kushte, Korporata, arriti të përmbush me sukses këtë përgjegjësi nëpërmjet prodhimit të brendshëm eficient, depozitim/shkëmbimit të energjisë veçanërisht me KEK, menaxhimit të tepricave nga PVPE për mbulimin e humbjeve në shpërndarje të kryerjes së transaksioneve shitblerjeje energjie në tregun e lirë dhe aktivitetit komercial me qëllim ekspozimin sa më të ulët ndaj importeve të shtrenjta. Në arritjen e këtij objekti, Korporata pati mbështetjen e gjithanshme të Qeverisë, e cila përveç përshtatjes së kuadrit ligjor/rregullator për përballimin e situatës, mbështeti direkt financiarisht Korporatën nëpërmjet buxhetit të shtetit, në përballimin e kësaj sfide;
- Në aspektin hidrik, viti 2022, konsiderohet një jo i mirë. Referuar indikatorëve kryesor si prurje, nivel shfrytëzimi, prodhim dhe rezervë energjitike ai paraqitet më optimal se vitet e thata 2019 dhe 2020, por larg parametrave të vitit 2021. Eventet e reshjeve të Nëntor-Dhjetor, ndryshuan diçka pozitivisht situatën hidrike duke përmirësuar disi edhe treguesit vjetor, por gjithsesi të pamjaftueshme për ta konsideruar si vit hidrik pozitiv. Për rrjedhojë, kjo ndikoi në volumet e prodhimit të brendshëm duke rritur riskun e ekspozimit të Korporatës ndaj importeve të shtrenjta. Në këtë situatë të ekspozimit ndaj riskut hidrik, Korporata administroi, operoi dhe shfrytëzoi kapacitetet hidrike në mënyrë mjaft racionale, për të prodhuar maksimumin e mundshëm të energjisë, dhe njëkohësisht për të ruajtur parametrat optimal të niveleve të shfrytëzimit dhe rezervës energjitike. Kjo u arrit nëpërmjet kombinimit të parashikimeve hidro-meteorologjike të sakta dhe planeve të operim/shfrytëzimit eficiente dhe të balancuara.
- Gjatë vitit 2022, Programi Ekonomiko-Financiar i Korporatës u hartua në përshtatje me situatën e emergjencës, me fokus kryesor përmbushjen sasiore të DSHP-së dhe me skenarët përkatës të përballimit të kësaj situatë. Theksi u vu kryesisht mbi aktivitetin në tregun e rregulluar dhe përmbushjen e DSHP-së. Aktiviteti i biznesit u parashikua më i kufizuar. Shpenzimet e përgjithshme operacionale u parashikuan të reduktuara, sipas principeve të optimizimit dhe eficiencës së kostove. Në lidhje me investimet, u planifikuan ato më të domosdoshmet, të lidhura kryesisht me rinovimet, të cilat sigurojnë një aktivitet operacional normal. PEF nuk u rishikua gjatë 2022;
- Aktiviteti tregtar gjatë 2022, u orientua ndaj sigurimit të sasive të energjisë për plotësimin e DSHP-së (tregu i rregulluar), në të gjitha mënyrat dhe të parashikuara në kuadrin ligjor/rregullator të situatës së emergjencës dhe me prioritet ekspozimin sa më minimal ndaj importit të energjisë me çmime të shtrenjta. Aktivitetet e tjera komerciale si shitja e energjisë në kushtet e prurjeve, optimizimi ekonomik, shërbimet e balancimit dhe shkëmbimi i energjisë u orientuan në krijimin e të ardhurave të cilat shërbenin në amortizimin sa më shumë të ishte e mundur e importeve të shtrenjta;

- Në rrafshin operativo-ekonomik, viti 2022 rezultoi me humbje. Kjo performancë ishte e pritshme, pasi situata e paprecedent e krizës globale së tregjeve të energjisë, shtuar edhe situata hidrike jopozitive e 2022, e ekspozuan ndjeshëm Korporatën ndaj riskut të tregut dhe atij hidrik. Kjo situatë emergjence nuk i siguroi Korporatës një aktivitet të një viti normal operativ, pasi në kuptimin e pozicionimit ndaj tregut dhe biznesit e vuri në kushte mbrojtje për shkak të përmbushjes së DSHP-së. Si entitet publik dhe prodhuesi kryesor i energjisë elektrike në vend, përgjegjësia dhe roli i shoqërisë ishte extra-biznes, pasi duhet të realizonte planin e veprimit të Qeverisë Shqiptare me objektiv përbalimin e situatës së emergjencës në sektor, për të siguruar energjinë e nevojshme dhe marrjen përsipër të barrës financiare duke mbrojtur konsumatorin final nga rritja çmimi të energjisë;
- Në aspektin e objektivit strategjik të shtimit të diversifikuar të kapaciteteve gjeneruese, viti 2022, shënoi një hap të rëndësishëm, pasi duke filluar nga Maj 2022, filloi zyrtarisht operimi i PV diga Qyrsaq/HEC Vau i Dejës me fuqi 5.14 MW, si kapaciteti i parë i diversifikuar i energjisë, duke iu shtuar asetete gjeneruese të Korporatës. Pavarësisht kufizimeve të krijuara nga gjendja e emergjencës, vazhdojnë me ecuri të kënaqshme projektet BRE si PV Lundruës/Vau i Dejës. Projekti HEC Skavica, PV Diga e Zadejës/Vau i Dejës, etj.;
- Në lidhje me liberalizimin e modelit të tregut të energjisë, viti 2022 konsolidoi tregun e balancimit sipas rregullave të reja të përhershme të balancimit. Për rrjedhojë, KESH sh.a. u çlirua dhe nuk e ka më detyrim për të dhënë këtë shërbim, siç ishte përcaktuar në rregullat e përkohshme të balancimit, ku Korporata ishte i vetmi subjekt që do të ofronte këtë shërbim. Pavarësisht kufizimeve nga situata e emergjencës tashmë lidhja dhe bashkëpunimi rajonal, sidomos me Kosovën janë realitet, i cili do të marrë hov më të madh edhe me hapjen e bursës së energjisë;

Viti 2023, parashikohet të jetë përsëri sfidues, për shkak të gjendjes së emergjencës në sektor. Fillimi i 2023 i gjen tregjet e energjisë ende me luhate në kuotime, por këto janë më të moderuara krahasuar me 2022. Gjithashtu vërehet një ulje e nivelit mesatar të çmimit, ku referuar HUPX çmimi mesatar i energjisë luhetet në nivelin rreth 140 Eur/MWh, duke paraqitur një stabilitet dhe ulje të ndjeshme krahasuar me 2022, por ende larg niveleve të para-krizës. Edhe të dhënat aktuale të HUDEX parashikojnë për 2023 një nivel çmimi bazë dhe peak, ndërmjet segmentit 110-140 Eur/MWh. Në aspektin hidrik, rezerva e lartë hidrike e fundvitit 2022 prej 1,193 GWh dhe situata optimale hidrike e fillimitit 2023, mund të konturojnë një vit pozitiv në prodhimin e brendshëm. Po kështu asetet termike lundruës me fuqi 110 MW, janë gjithashtu një garanci në prodhim sidomos për periudhat e thata, duke rritur dhe optimizuar profilin e prodhimit të brendshëm. Korporata është edhe më e përgatitur në përbalimin e situatës së emergjencës duke parashikuar edhe skenarët e mundshëm.

Në përfundim, falë edhe vizionit të stafit drejtues për zhvillimin e Korporatës dhe mbështetjes së madhe të Qeverisë Shqiptare, objektivat e KESH sh.a., mbeten të fokusuar në këto drejtime:

1. Garantimin e furnizimit për detyrimin e shërbimit publik, sipas kuadrit ligjor dhe rregullator, për kapërcimin me sukses të situatës së emergjencës;
2. Rritjen e sigurisë dhe eficiencës së veprave të mëdha energjetike, në Kaskadën e Drinit nëpërmjet rinovimeve të vazhdueshme kapitale dhe modernizimit teknologjik;
3. Shtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese (kryesisht PV, por jo vetëm), për diversifikimin e portofolit gjenerues nëpërmjet Burimeve të Rinovueshme të Energjisë. Kjo strategji zhvillimore jo vetëm do fillojë të ulë varësinë e prodhimit nga forma hidro, por kombinimi i të dyjave do të sillte optimizim të rezervës energjetike, nëpërmjet operimit hibrid të burimeve gjeneruese, me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga aktiviteti komercial;
4. Komercializimi i mëtejshëm i aktivitetit ekonomik, nëpërmjet sjelljes proaktive, pjesëmarrëse në treg, shtrirja e mëtejshme aktivitetit në nivelin rajonal, si dhe modernizimit të procedurave të tregtimit të energjisë elektrike;
5. Përgatitja dhe transformimi i vazhdueshëm i Korporatës drejt një tregu të liberalizuar, nëpërmjet orientimit të burimeve njerëzore drejt metodave dhe stilit të punës në skuadër, rritjes së performancës/produktivitetit dhe qasja drejt praktikave më bashkëkohore të zhvillimit të biznesit dhe teknologjisë.